



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Prill 2021/ Nr. 4



1 maj-14 qershor 2021
"Defender Europe 21"
-prioriteti kryesor i FARSH
për vitin 2021



Marrëveshje bashkëpunimi
Nënskruhet marrëveshja
për trajtimin mjekësor të
ushtarakëve shqiptarë në Turqi



Intervista
Kërkim-shpëtimi,
detyrimi ndërkombëtar
dhe shtetëror shqiptar



MINISTRI PELESHI NË TURQI, PRITET NGA HOMOLOGU HULUSI AKAR
Ministri Peleshi: Jemi të hapur për investime
të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes

Përmbajtja

Numri 4

REGJIMENTI I OPERACIONEVE SPECIALE

- 5** Ministri Peleshi: Ju jeni krenaria dhe dinjiteti ynë në angazhimet tona jashtë vendit

TAKIMI

- 3** SEDM, një sukses i bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes

FORCA DETARE

- 22** Zhvillohet stërvitja e përbashkët me anijen e Flotës 6-të të SHBA "USS Monterey"

ARKIVI QENDROR I FA

- 37** Hapen dokumentet arkivore për Luftën e Dytë Botërore dhe Luftën e Ftohtë

BOTIME USHTARAKE

- 42** Zeno Jahaj dhe libri doktrinë për gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 VIZITA

Ministri Peleshi: Jemi të hapur për investime të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës zyrtare në Turqi u prit më 10 mars 2021, nga homologu i tij Hulusi Akar, me një ceremoni ushtarake në ambientet e Ministrisë...



6 MODERNIZIMI I FA

SHBA dhurojnë 29 mjete të blinduara "Humvee" për Batalionit II të Këmbësorisë


Në ceremoninë e zhvilluar në Zall Herr, u cilësua se Batalioni II i Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b2k) është një hap më pranë mekanizimit të plotë...



31 INTERVISTA

Kërkim-shpëtimi, detyrimi ndërkombëtar dhe shtetëror shqiptar

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është një strukturë relativisht e re në Ministrinë e Mbrojtjes, por me një përgjegjësi të madhe shtetërore. Kjo për faktin se Shërbimi...



42 PROJEKTI 7 VJEÇAR

Norvegjezët modernizojnë Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake

Në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze për projektin e hartave detare. IGJIU ka planifikuar të realizojë...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 4/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Ministri Peleshi në Turqi, pritet nga homologu Hulusi Akar

Ministri Peleshi: Jemi të hapur për investime të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes

Ministrat Peleshi dhe Akar diskutojnë për implementimin e dy marrëveshjeve financiare ushtarake të cilat do të përdoren për rritjen e kapaciteteve luftarake dhe logjistike të FA shqiptare.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës zyrtare në Turqi u prit më 10 mars 2021, nga homologu i tij Hulusi Akar, me një ceremoni ushtarake në ambientet e Ministrisë. Dy ministrat zhvilluan fillimisht një takim kokë më kokë dhe më pas drejtuan takimet ndërmjet delegacioneve. Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Turqisë dhe forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve mes dy vendeve tona ishte tema kryesore e bisedës mes dy ministrave. Në këto bisedime, ku palët shkëmbyen mendimet lidhur me sigurinë bilaterale e rajonale, çështjet e mbrojtjes dhe shanset e bashkëpunimit në fushën e industrisë së mbrojtjes, ministri Akar vuri theksin mbi bashkëpunimin e afërt mes Turqisë dhe Shqipërisë. Ministri Peleshi e falënderoi homologun e tij për mbështetjen që Turqia

ia ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm në modernizimin e logjistikës së Forcave të Armatosura e Emergjencave Civile, por edhe në arsimimin e ushtarakëve të rinj shqiptarë. Në takim u diskutua edhe implementimi i dy marrëveshjeve financiare ushtarake, grant i palës turke, të cilat do të përdoren për rritjen e kapaciteteve luftarake dhe logjistike të FA shqiptare.



Ministri Peleshi theksoi faktin se Republika e Kosovës është shumë e rëndësishme për Shqipërinë dhe rikonfirmoi qëndrimin e qartë të qeverisë shqiptare se e vetmja zgjidhje për një paqe afatgjatë në rajon është njohja e pavarësisë së Kosovës nga Beogradi.

Zoti Peleshi i shprehu homologut të tij Hulusi Akar se vendi ynë mbetet i hapur për investimet e përbashkëta në fushën e Industrisë së Mbrojtjes dhe se mirëpresim çdo ofertë serioze nga kompanitë turke në këtë fushë. Vizita zyrtare e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi në Ankara, vjen në vijim të vizitës së kryeministrit Rama në fillim të këtij viti, ku u prit me nderime nga presidenti i Turqisë Recep Tayyip Erdogan.





MINISTRI PELESHI

“Ju jeni krenaria dhe dinjiteti ynë në angazhimet tona jashtë vendit”

Regjimenti i Operacioneve Speciale është struktura më e re dhe më elitare e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Regjimenti u krijua pas bashkimit të Batalionit të Forcave Speciale dhe atij Komando. Rreshtimin e parë organik të kësaj strukture, e përshëndeti ditën e enjte të javës që kaloi, datë 4 mars 2021, edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj.

Ministri Peleshi vlerësoi kontributin shumëvjeçar të dy batalioneve tashmë të bashkuar, si dhe i siguroi efektivët e tyre se do të kenë vëmendjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm për të rritur më tej kapacitetet operacionale.

“Ky regjiment, pavarësisht se bëhet njësi me moshën më të re në Forcat e Armatosura, në të vërtetë ka dy formacionet tona ushtarake



Regjimenti i Operacioneve Speciale do të jetë në prioritetet tona për plotësimin me personel, por edhe për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak

më të mirënjohura, më të vlerësuara dhe me një bilanc angazhimesh, kontributesh, suksesesh që na bëjnë të gjithëve krenarë. Ju jeni krenaria dhe dinjiteti i Forcave të Armatosura në detyrimet dhe angazhimet tona jashtë vendit, duke filluar nga misionet në Irak, Afganistan dhe deri në Kosovë. Si ministër i Mbrojtjes, e ndjej për detyrë t’ju inkurajoj dhe t’ju mbështes për ta konsoliduar më tej imazhin tuaj të mirë, kapacitetet operacionale dhe rolin tuaj, nën emrin e ri të regjimentit. Si një strukturë e re, Regjimenti i Operacioneve Speciale do të jetë në prioritetet tona për plotësimin me personel, por edhe për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak, për të mundur arritjen e standardeve dhe objektivave të caktuara. Unë ju siguroj se veçanërisht regji-

mentit tuaj, edhe Forca Tokësore e Forcat e Armatosura do të ketë një vëmendje të shtuar për mbështetje, përmirësime cilësore dhe motivime të tjera domethënëse.”-u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Komandanti i parë i Regjimentit të Operacioneve Speciale u emërua kolonel Arben Zani. Nga ana e tij, kolonel Arben Zani, në ditën e emërimit të tij, muajin që kaloi falënderoi ministrin e Mbrojtjes, shefin e Shtabit të Përgjithshëm si dhe komandantin e Forcës Tokësore për besimin që kanë treguar me emërimin e tij në një strukturë të rëndësishme për FA-në siç është Regjimenti i Operacioneve Speciale. Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për këtë njësi të sapo krijuar por dhe për Forcën Tokësore në tërësi.



Modernizimi i Forcave të Armatosura

SHBA dhurojnë 29 mjete të blinduara

“Humvee” për Batalionit II të Këmbësorisë

Në ceremoninë e zhvilluar në Zall Herr, u cilësua se Batalioni II i Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b2k) është një hap më pranë mekanizimit të plotë të tij. Qeveria e SHBA dhuroi 29 mjete

të reja, të blinduara, shumëpërdorimshme dhe me lëvizshmëri të lartë (Humvee) për këtë strukturë të deklaruar në NATO.

Ministri Peleshi, ditën e mërkurë, më 24 mars 2021, përshëndeti SHBA për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për

modernizimin e FA, trajnimin dhe arsimimin e efektivëve tanë. “Ndi-hma materiale, teknike dhe modernizuese e SHBA, i ka dhënë dhe u jep ushtarakëve tanë më shumë fuqi, forcë dhe efektivitet në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Në sajë të kësaj ndihme, ata janë



Ambasadore e SHBA, Yuri Kim: Dhurimi i 29 mjeteve të reja, është si një donacion i rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Evropën Juglindore.

e të tjera, ka qenë domethënëse për FA. 29 mjete të blinduara dhe armatimi luftarak për të cilat jemi mbledhur sot në këtë event sigurisht që nuk janë dhe nuk do të jenë të fundit. Kjo ndihmë dhe mbështetje për forcimin e muskujve ushtarakë të dy prej njësive tona kryesore siç janë batalioni i II dhe ai i Forcave Speciale është shumë më tepër se kontributi real dhe konkret rritjen e kapaciteteve të tyre operacionale luftarake. Kapacitetet tona janë kapacitetet tuaja, janë kapacitetet e aleancës, FA shqiptare do të jenë gjithmonë me ju gjithmonë me aleancën në mbrojtjen dhe sigurimin e vlerave tona të përbashkëta.", iu drejtua ministri Peleshi ambasadores së SHBA, Yuri Kim.

Nga ana e saj, ambasadorja Kim tha se dhurimi i mjeteve të reja kontribuon në transformimin e Batalionit II të Këmbësorisë, nga një batalion i lehtë, në një batalion të mekanizuar. Diplomati amerikane u shpreh krenare që Shqipëria i përgjigjet detyrës, duke qenë gjithmonë në krah të SHBA, pavarësisht sa të rrezikshme janë misionet, pavarësisht sa larg shtëpisë.

Dhurimin e 29 mjeteve të reja, ajo e konsideroi si një donacion të rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Evropën Juglindore. Mjetet e reja të dhuruara nga SHBA do të përdoren kryesisht nga Batalioni II i Këmbësorisë në Forcën Tokësore, i cili është një strukturë në gatishmëri dhe dispozicion të Aleancës për t'u dislokuar kudo dhe kurdo.



më të trajnuar për të përmbushur me sukses pothuajse të gjithë spektrin e misionëve dhe detyrave. Kjo mbështetje e vazhdueshme e fuqishme dhe thelbësore ju ka dhënë veçanërisht trupave tanë të angazhuar jashtë vendit më

shumë besim, siguri dhe dinjitet në krye të detyrave të tyre. Modernizmi i teknikës dhe i pajisjeve duke filluar me mjete komunikimi detare, ajrore, mjete të blinduara dhe pajisje të tjera luftarake tokësore, mjete të mbrojtjes kimike

Ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim

Misioni ynë nuk ka përfunduar, ruani nivelet më të larta të bashkëpunimit

Mirëmëngjes Ministër Pelesh, Gjeneral Begaj dhe të ftuar të nderuar. Do të doja të falënderoja veçanërisht mikpritësin tonë, Gjeneral Kingjin, për mirëpritjen time në Zall Herrshtëpinë e Forcave Tokësore Shqiptare. E sotmja nuk është thjesht një mundësi për të kryer një ceremoni, por një mundësi për të takuar komandantin e ri të forcës tokësore të Shqipërisë. Gjeneral, ju përgëzoj për marrjen e këtij roli të rëndësishëm.

Jemi këtu për të festuar dorëzimin e 29 Automjeteve Ushtarake të Lëvizshmërisë së Lartë, ose "Humvee", për Forcat e Armatosura Shqiptare. Këto automjete të reja do të përmirësojnë menjëherë aftësitë e forcave tokësore shqiptare në një moment kritik. Ky gur kilometrazhi i fundit është pjesë e një projekti parësor për Shtetet e Bashkuara-për të ndihmuar në tranzicionin e batalionit të dytë të këmbësisë së Shqipërisë nga një Grup-Beteje i Këmbësisë së Lehtë në një Grup-Beteje i Këmbësisë së Motorizuar.

Angazhimi i Shqipërisë për të përgatitur një Grup-Beteje të Këmbësisë së Motorizuar për NATO-n është domethënës. Ai përforcon rëndësinë e angazhimeve të NATO-s dhe na kujton se Shqipëria është e gatshme të veprojë në vende të rrezikshme përkrah aleatëve. Pasi të përfundojë, ky projekt do të përmirësojë aftësinë e Shqipërisë për të kryer misione të brendshme mbrojtëse dhe për të zbarkuar në mbështetje të operacioneve globale. Shtetet e Bashkuara mbeten mirënjohëse që Shqipëria i është përgjigjur thirrjes në vende të ndryshme nëpër botë.

Ky dhurim është gjithashtu ven-

Fjalimi i Ambasadores Yuri Kim mbajtur më 24 mars 2021, në ceremoninë për Dhurimin e Mjeteve Humvee për Forcat e Armatosura Shqiptare

dimtar, sepse jemi në përgatitjet e fundit për një ngjarje historike -Stërvitja "Defender 21". "Defender 21" është një stërvitje

ushtarake shumëkombëshe, e cila do të ndodhë në Shqipëri këtë verë dhe Shqipëria është zgjedhur për të mikpritur një aspekt të rëndë-



sishëm të stërvitjes. Kjo do të jetë stërvitja më e madhe ushtarake ndonjëherë në Evropën Juglindore dhe sigurisht do të tregojë rëndësinë e Shqipërisë në rajon. Në mënyrë të veçantë, presim me kënaqësi t'i shohim këto automjete të marrin pjesë në këtë ngjarje premierë trajnimi.

Dua të falënderoj Ministrin Peleshi dhe Gjeneral Begajn për udhëheqjen e tyre të jashtëzakonshme dhe dua të falënderoj stafin e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes për punën e tyre të vështirë në realizimin e kësaj. Misioni ynë nuk ka përfunduar ende dhe ju bëj thirrje që të ruani nivelet më të larta të bashkëpunimit.

Është me të vërtetë një kohë emocionuese të jesh ushtar në Forcat e Armatosura të Shqipërisë ose ushtar amerikan që shërben në Shqipëri. Ne jemi të nderuar të qëndrojmë krah për krah me ju dhe të shohim përpara për rritjen e bashkëpunimit ushtarak në muajt në vijim.



SHKËMBIM PERSONELI NË MËSIMDHËNIE
ME INTERES TË PËRBASHKËT

Akademia e Forcave të Armatosura marrëveshje me Universitetin “Marin Barleti”

Në Rektoratit e AFA-së, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Albert Mullai dhe Znj. Esmeralda Hasani, përfaqësuese e Universitetit “Marin



Barleti”, nënshkruan më 3 mars 2021, marrëveshje bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Marrëveshja e nënshkruar parashikon ndër të tjera, shkëmbim të personelit akademik për mësimdhënie në lëndët e modulet me interes të përbashkët, programe studimi të përbashkëta, kualifikim të personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve, workshop-eve, konferencave shkencore, udhëheqjeve shkencore, shfrytëzimin e bibliotekave nga personeli akademik dhe studentët e dy institucioneve, etj.



“LIGJI PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA”

Ministri Peleshi: Ligji garanton rekrutime të sigurta si për ushtarët ashtu edhe për oficerët



Konsultimi publik “Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura” ka marrë në konsideratë propozimet e bëra nga grupi këshillues amerikan

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi më 16 mars, në seancën parlamentare se ndër risitë që sjell Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura është garantimi i rekrutimeve të sigurta si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët.

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, ku u shqyrtua Dekreti i Presidentit të Republikës, për kthimin e ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, Peleshi tha se ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura ka si objekt përcaktimin e normave dhe të rregullave të hollesishme të rekrutimit, përparimit në karrierë, dhe lirimit ose daljes në rezervë të ushtarakëve.

“Ligji aktual në fuqi, -shtoi Peleshi, -në krahasim me ligjin e mëparshëm mundësoi gjatë këtyre 7 viteve, largimin e të rekrutuarve jashtë karriere, rritjen e kohës së qëndrimit

të FA-ve të gradave të larta, duke i afruar ndjeshëm me moshën e pensionit. Uljen e kostove të trajtimit të personelit që paguhet me pension të parakohshëm dhe me pagesë kalimtare, përfshirjen e nën/oficerëve në sistemin e vlerësimit në Komisionet e karrierës ku shqyrtohen dhe trajtohen nënoficerët”.

“Gjatë implementimit të ligjit në këto 7 vite, përveç anëve pozitive të shumta që solli për FA-në, janë identifikuar edhe disa problematika, të cilat nevojitet të adresohen për të garantuar në të ardhmen një sistem të sigurt rekrutimi, rritje të performancës së personelit ushtarak dhe garantimin e karrierës së tyre në FA”, -u shpreh Peleshi.

Ai nënvizoi se risitë që sjell ndryshimi i këtij ligji janë: “Garantimi i rekrutimeve të sigurta si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët; Trajtimin dinjitoz të studentëve ush-

tarakë që zgjedhin për të studiuar dhe më pas për të shërbyer në FA; Rritjen e konkurrencës për të përzgjedhur më të mirët për nën/oficerë aktivë nga personeli i ushtarëve në FA; Kushte e kritere të njëjta për të gjithë personelin ushtarak nën/oficer dhe oficer në FA; Garantimi i përfitimit të trajtimit sipas statusit të ushtarakut edhe për gradat e ulëta; Mbështetjen e personelit me specialitete të veçanta në FA, për të cilët është konstatuar vështirësi në rekrutim dhe në trajtimin e tyre; Plotësimin e nevojave për ushtarë dhe në ato reparte ku kemi vështirësi për rekrutimin e tyre; Zgjidhjen e problematikës së ushtarakëve ndër vite, që për arsyë të ndryshme nuk kanë një urdhër lirimi nga FA; Rritja e pagave, rritja e trajtimit financiar sipas vështirësive; Rifillimi i trajtimit të munguar të kompensimit të ushqimit; Fillimi i sistemit të ri arsimor bachelor në FA”.

"Mbështetja që u jep ushtarakëve ky ndryshim ligji dhe mbështetja që do të vijojë të shtohet vit pas viti për ushtarakët në FA do të krijojë një bazë të fuqishme profesioniste në realizimin e detyrave si brenda ashtu dhe jashtë vendit dhe do t'i bëjë të ndihen më dinjitozë krah kolegëve të tyre në familjen e madhe të aleancës politiko-ushtarake NATO", -theksoi Peleshi.

Lidhur me konsultimin publik, ministri Peleshi theksoi se: "Konsultimi publik për ligjin ka nisur më datë 25 mars 2019 dhe në mbledhjet e grupit të punës, krahas sugjerimeve nga strukturat e brendshme, janë marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga grupi këshillues amerikan. Është vijuar me publikimin e draftit në regjistrin elektronik të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA. Konsultimi publik është mbydhur në 30 shtator 2020. Kurse për disa specifikime arsimore, ai sqaroi se: "Rekrutimi i ushtarëve detarë/aktiv me arsim 9 vjecar do të bëhet vetëm në raste të kufizuara përjashtimore dhe kur diktohet nga rrethana të caktuara si: vendndodhja, rëndësia e repartit ushtarak apo kryerja e detyrave specifike komplekse të cilat nuk kanë nevojë për personel apo trajtim të avancuar". Ai tha se: "Veprimtaria e Forcave të Armatosura shfaq dinamika të reja e të vazhdueshme të cilat shoqërohen me ndryshime strukturore apo nevojiten për afrimin e specialiteteve të ndryshme. Ky ndryshim ka në thelb trajtimin e diferencuar të një kategorie ushtarakësh të cilët kanë specialitete të veçanta e që mund të kontribuojnë në fusha të veçanta nëveprimtarinë e Forcave të Armatosura. Emërimi në një funksion më të ulët organik i ushtarakut të Forcave të Armatosura bëhet për një periudhë deri në 1 vit dhe për çdo periudhë përtej këtij viti është i nevojshëm pëlqimi me shkrim paraprak i ushtarakut. Ky parashikim ka për qëllim plotësimin e përkohshëm të pozicioneve organike të cilat kryejnë detyra specifike dhe nuk mund të qëndrojnë vakante dhe është gjithashtu në përputhje me doktrinën ushtarake në të cilën parashikohet se: "ushtaraku kryen shërbimin e tij kudo ku paraqitet e nevojshme". Ndërkohëqë trajtimi financiar do të jetë sipas gradës", ka përfunduar Ministri Peleshi.

Peleshi: Keni bërë zgjedhjen e duhur

254 kandidatë për ushtarë nisen për Bunavi, Vaun e Dejës dhe Poshnje

Nga 254 kandidatë për ushtarë, 21 prej tyre janë vajza dhe 11 janë me arsim të lartë

254 djem dhe vajza u përzgjedhën për të kryer Stërvitjen Individuale Bazë, përpara se të titullohen ushtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Të rinjtë dhe të rejat u përcollën personalisht më 3 mars 2021, nga ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Në zbatim të masave anti-COVID, ceremonia e përcjelljes u zhvillua me një numër shumë të kufizuar të rekrutëve të rinj.

Ministri Peleshi i përgëzoi rekrutët për zgjedhjen për t'u bërë pjesë e FA-së dhe i siguroi ata se do t'i mbështesë personalisht në rrugëtimin e tyre. "Shumë shpejt do ta kuptoni që keni bërë zgjedhjen e duhur. Unë ju siguroj se do të keni vëmendjen dhe kujdesin tim të vazhdueshëm si ministër i Mbrojtjes, por pa dyshim, edhe të të gjithë komandantëve dhe drejtuesve tuaj ushtarakë. Ju do të jeni ata që do të shërbeni dhe nderoni Shqipërinë në misionet aktuale, por dhe ato të së ardhmes. Kjo do të thotë që ju nuk do të jeni vetëm ushtarë të Forcave të Armatosura



shqiptare, por dhe ushtarë të Aleancës, ju do të jeni ushtarë të NATO-s." - iu drejtua ministri djemve dhe vajzave.

Duke folur për arsimimin në Forcat e Armatosura, ministri Peleshi informoi të rinjtë për objektivat e tij për të sjellë risi në Akademinë e FA-së. "Jeni shumë pranë finalizimit për të hapur degën e teknologjive të informacionit në fushën e mbrojtjes, që do të thotë, kush mbaron bachelorin, mund të punojë në fushën e mbrojtjes, në specialitetin e teknologjive të informacionit. Duam të hapim edhe një master të sigurisë kibernetike. Dikush prej jush apo kushdo tjetër, mund të ndjekë këtë master dhe të specializohet në një fushë për të cilën jo Shqipëria, por bota ka më shumë kërkesë sesa ofertë." -u shpreh zoti Peleshi.

Për shkak të pandemisë rekrutët do ta zhvillojnë Stërvitjen Individuale Bazë, jo vetëm në Shkollën e Trupës në Bunavi, por edhe në mjediset e Batalionit të I-rë të Këmbëtorisë në Vaun e Dejës dhe Batalionit të III-të të Këmbëtorisë në Poshnje të Beratit. Shpërndarja e rekrutëve është bërë edhe në bazë të vendbanimit të tyre, me qëllim që të jenë sa më afër banesës. Nga 254 kandidatë për ushtarë, 21 prej tyre janë vajza dhe 11 janë me arsim të lartë.

“Defender Europe 2021”, rikonfirmim i partneritetit strategjik Shqipëri-SHBA

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ditën e hënë, më 8 mars 2021, projektligjin për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 2021”. Projektligji u miratua me 98 vota pro, 6 kundër dhe 1 abstenim. Qëllimi i tij është të lejojë hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3.100 trupave ushtarake nga disa vende pjesëmarrëse në stërvitje.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, gjatë fjalës në seancën parlamentare, u shpreh se miratimi i projektligjit për stërvitjen “Defender Europe 2021” i cili ka 9 nene, është rikonfirmim i qartë i partneritetit strategjik që ekziston ndërmjet vendit tonë dhe SHBA-ve. Gjatë fjalës së tij në Kuvendin e Shqipërisë, Peleshi theksoi se, ky projektligj, do të kontribuojë në dobi të fuqizimit të sigurisë kombëtare të vendit tonë dhe forcimin e partneritetit strategjik Shqipëri-SHBA. Sipas tij, projektligji “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”, ka të bëjë me një ndër stërvitjet ushtarake më të mëdha që janë zhvilluar ndonjëherë në vendin tonë.

“Stërvitja “Defender Europe 21” zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën amerikane dhe është në vazhden e partneritetit të fortë strategjik që vendi ynë ka me SHBA-në, në fushën e sigurisë



Pjesë e kësaj stërvitjeje do të jetë pjesëmarrja e forcave të vendeve aleate dhe partnere, si: Kanadaja, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.”



dhe mbrojtjes. Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë paketën e stërvitjeve të koduar “Defender Europe 21” dhe pjesë e kësaj pakete do të jetë pjesëmarrja e forcave të vendeve aleate dhe partnere, si: Kanadaja, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.”,-tha Peleshi.

Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje do të jetë demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t'u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe ato të NATO-s, në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks.

“Kryefjala jonë për këtë stërvitje do të jetë “Gatishmëri, ndërveprueshmëri dhe operacionalitet”

me forcat aleate, siç bëjmë prej dekadash tashmë në operacione dhe misione të NATO-s, BE-së, OKB-së, etj. Gjithashtu, me zhvillimin e kësaj stërvitjeje, synohet të testohen procedurat kombëtare në koordinimin me autoritetet e tjera të vendit për përdorimin e aeroporteve, porteve, hapësirës ajrore dhe detare, procedurat për kalim transit në territorin e vendit tonë, si dhe procedurat tona kombëtare si vend pritës”,-u shpreh ministri.

Për këtë qëllim, bëri të ditur Peleshi, para disa javësh patëm kënaqësinë të mirëprisnim gjeneral Jarrard dhe të angazhoheshim me aktorët kryesorë në vend në Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Dhe javën që vjen, një tjetër zyrtar ushtarak i lartë amerikan, gjenerali Mohan, do zhvillojë një rikonjicion mbi masat dhe përgatitjet në proces për mbajtjen e stërvitjes. Është mëse evident investimi dhe fokusi amerikan në

këtë aktivitet, ku Shqipëria përbën një pjesë qendrore.

“Zhvillimi i stërvitjes dhe pjesëmarrja e një numri të madh trupash ushtarake në këtë stërvitje, do të rrisin bashkëpunimin ndërmjet vendeve. Duke realizuar me sukses angazhimet e marra përsipër në këtë projektligj, vendi ynë tregon se është i aftë të bashkëpunojë, mirëpresë dhe zhvillojë stërvitje të rëndësishme dhe me numër të madh trupash dhe mjetesh”, -theksoi ai.

Sipas tij, disa dimensione kryesore të këtij angazhimi janë: disa stërvitje me tematikë më të kufizuar dhe periudha kohore të ndryshme. Forcat Ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të marrin pjesë me 1 mijë efektivë në komponentë të ndryshëm të stërvitjes si: stërvitjen “Immediate Response 21” (17 maj-2 qershor); stërvitjen “Saber Guardian 21” (16 maj-10 qershor) dhe në stërvitjen “Astral Knight 21” (13 maj-21 maj).

Komponent i rëndësishëm i këtyre stërvitjeve, do të jenë mjetet ajrore dhe detare, teknika dhe sistemet e armatimit që do të përdoren, ku ndër më kryesoret përmendim: 6 sisteme raketash “Patriot”; 25 mjete fluturuese: (10 avionë F15, 2 avionë F16, 2 avionë F35, 3 avionë tip KC-135, për furnizim në ajër; 7 helikopterë për kërkim-shpëtim, 1 avion patrullimi C-130, 12 helikopterë shumërolësh dhe MEDEVAC); 1000 automjete të ndryshme (jo luftimi) transporti mallrash, personeli dhe mjete xheniere; 10 mjete detare.

Ndërkohë, pjesëmarrja e FARSH-it në këtë paketë stërvitjesh ndikon në rritjen e aftësive operacionale të trupave tanë, veçanërisht të disa prej njësive dhe reparteve tona të deklaruara në NATO. Mbajtja e kësaj stërvitje në vendin tonë është e një rëndësie strategjike. Ndërveprueshmëria, integrimi i strukturave tona dhe zhvillimi i aktivitetit të përbashkët stërvitor do të përcjellë mesazhe të shumëfishta me impakt strategjik në fushën e bashkëpunimit, sigurisë dhe mbrojtjes.

“Përzgjedhja e Shqipërisë për zhvillimin e kësaj stërvitje, së bashku me disa vende, do të sigurojë vizibilitet të konsiderueshëm dhe besueshmëri për vendin tonë, jo vetëm

në kuadër të Aleancës por edhe në kuadrin rajonal. Me shumë rëndësi do të jetë mesazhi që do të përcjellë kjo stërvitje për vendet e lëkundura të rajonit tonë, apo dhe vendet që kanë axhenda dhe interesa të ndryshëm nga ato në të cilat beson dhe është i orientuar vendi ynë dhe rajoni, “Në



Orientimin Euroatlantik”. Shqipëria edhe njëherë tregon qartësisht Rolin Thelbësor që luan dhe do vijojë të luajë për të mbajtur sa më larg rivalët tanë nga rajoni i Ballkanit, të pozicionuar pa ekuivok në “Hapësirën Perëndimore”, -deklaroi Peleshi.

Në aspektin kombëtar, theksoi ai, mbajtja e stërvitjes “Defender Europe 21” në vendin tonë, do të jetë një mundësi e shkëlqyer për promovimin e vlerave të Forcave tona të Armatosura në komunitet. Kjo stërvitje do të shërbejë edhe si “promovimi” më i mirë për FARSH-in, duke dëshmuar edhe një herë se ushtarakët tanë janë pjesa më vitale e shoqërisë. Kjo është faktuar vazhdimisht, në çdo kohë, në çdo moment, sidomos në ato të këqija, siç ndodh gjatë përmbytjeve, tërmetejeve, zjarreve dhe së fundmi dhe në këtë pandemi, ku FA pritet të luajë një rol dhe në planin kombëtar të vaksinimit.

“Shpalosja e aftësive ndërvepruese dhe bashkëpunuese ndërmjet FARSH-it dhe trupave aleate, si dhe demonstrimi i kapaciteteve operacionale të FARSH-it, do të ndihmojnë të rinjtë tanë në orientimin e tyre në karrierë si dhe do të shërbejë si nxitje për bërjen e tyre pjesë të Forcave të Armatosura. Stërvitja Defender Europe, ndër

të tjerash, do shërbejë dhe si një shtysë për vijimin e modernizimit të gjithanshëm të Forcave Armatosura, një proces i pandalshëm, në frymën e “Zotimit të Investimeve të Mbrojtjes”.

Në gjithë këtë aktivitet shumëdimensionalësh, ne do tregojmë një

kujdes të veçantë për ambientin dhe mjedisin në afërsi të vendeve stërvitore, ku parësor mbetet bashkëpunimi me autoritetet dhe komunitetet lokale. Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë situatën e pandemisë, FA në koordinim të plotë me palën amerikane do të kenë pjesë të skenarit dhe aspektet e masave dhe mbrojtjes nga COVID-19, në përputhje me direktivat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe legjislacionin dhe rregullat”, -deklaroi ministri Peleshi.

Ligji nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit. Për sa u përket kostove financiare që mbart zhvillimi i këtyre stërvitjeve, FARSH-i ka për detyrim vendosjen në dispozicion të infrastrukturës stërvitore, mjetet tokësore, detare dhe ajrore. Shpenzimet për palën amerikane dhe vendet e tjera pjesëmarrëse, të cilat do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë do të mbulohen nga vetë palët. Pala jonë ka detyrimin për mbulimin e shpenzimeve për forcat dhe mjetet tona pjesëmarrëse. Kosto e përafërt për pjesëmarrjen në këto stërvitje (karburant, lubrifikant) është rreth 436,712 euro. Këto kosto do të përballohen nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2021.

“Defender Europe 21”-prioriteti kryesor i FARSH për vitin 2021

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj priti më 10 mars 2021, në një vizitë pune në Shqipëri në kuadër të masave përgatitore të stërvitjes “Defender Europe 21”, Komandantin e Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA për Evropën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan.

Në fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj vlerësoi partneritetin strategjik dhe bashkëpunimin midis dy vendeve duke nënvizuar asistencën e SHBA për Shqipërinë në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj siguroi se stërvitja “Defender Europe 21” mbetet një nga prioritetet e FARSH për vitin 2021. “Janë duke u marrë të gjitha masat e duhura për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitje. “Defender Europe 21” do të shërbejë jo vetëm si një platformë për të testuar kapacitetet operacio-



Komandanti i Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA për Evropën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan, inspekton masat për stërvitjen “Defender Europe 21”



nale të FARSH dhe integrimin me forcat e tjera shumëkombëshe, por gjithashtu do të promovojë infrastrukturën kritike të Shqipërisë për mbështetjen e stërvitjeve të mëdha në kuadër të Aleancës. Dua të vlerësoj gjithashtu identifikimin dhe përfshirjen e Portit të Durrësit dhe Bazës Ajrore të Kuçovës si infrastrukturë strategjike për

dislokimin e trupave.” u shpreh gjeneralmajor Begaj.

Stërvitja “Defender Europe 21”, e drejtuar nga SHBA, do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të Aleancës për vitin 2021 dhe do të zhvillohet në territorin e 14 vendeve të Europës. Stërvitja “Defender Europe 21” do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021.

“Defender Europe 21”

Në kuadër të zhvillimit të stërvitjes së përbashkët të koduar “Defender Europe 21” gjeneralmajor Mohan, komandanti i Komandës Mbështetëse të SHBA për Evropën dhe Afrikën zhvilloi më 10 mars 2021, një vizitë njohëse në mjediset e Batalionit të Xhenios.

Në këtë vizitë njohëse ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj. Gjatë kësaj vizite u panë nga afër investimet e kryera nga pala amerikane për infrastrukturën në këtë garnizon, të cilat shërbejnë për magazinimin dhe ruajtjen e ba-

Gjeneralmajor Christopher O. Mohan në Batalionin e Xhenios

zës materiale sipas kushteve dhe rregullave të administrimit.

Të pranishmit u njohën nga komandanti i Batalionit të Xhenios mbi detyrat, mision, pajisjet dhe asetet që disponon Kompania EOD në kryerjen e detyrave për asgjësimin e municioneve të rrezikshme. Gjithashtu ato u njohën edhe me kontributin e Kompanisë EOD për kryerjen e misioneve jashtë vendit (në kuadër të NATO dhe OKB).



Në kuadër të zhvillimit të stërvitjes së përbashkët “Defender Europe 21” gjeneralmajor Christopher O. Mohan, komandanti i Komandës Mbështetëse të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, zhvilloi një vizitë njohëse në mjediset e Komandës së Forcës Detare. Në këtë vizitë njohëse ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj. Gjeneralmajor Mohan në Komandën e Forcës Detare u prit nga komandanti, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Gjeneral brigade Xhebexhia i njohu të pranishmit me masat e marra nga Forca Detare në kuadër të stërvitjes “Defender Europe 21”.

Më parë, në kuadër të masave përgatitore për stërvitjen “Defender 21”, Komandanti Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan është takuar me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ka zhvilluar një vizitë njohëse në mjediset e Batalionit të Xhenios.

Gjeneralmajor Mohan në mjediset e Komandës së Forcës Detare



Komandanti i Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Mohan është takuar me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ka zhvilluar një vizitë njohëse në mjediset e Batalionit të Xhenios.



Në kuadër të ristrukturimit të Forcës Tokësore

Gjeneralmajor Begaj, inspektoi Batalionin e Parë të Këmbësorisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, inspektoi Batalionin e Parë të Këmbësorisë (b1k) të Forcës Tokësore, në Vaun e Dejës, Shkodër, në kuadër të ristrukturimit të Forcës Tokësore.

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi efektivët e b1k për përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm të tyre në ndihmë të komunitetit gjatë emergjencave civile, si përmbytjet, bllokimit të rrugëve nga reshjet e dëborës në zona të caktuara, tërmeteje etj.

“Batalioni juaj është vlerësuar dhe ka një bilanc angazhimesh,



kontributesh e suksesesh, që na bëjnë të gjithëve krenar. Ju keni mbajtur lart flamurin e Shqipërisë në disa misione jashtë vendit, angazhime

të cilat do të kërkohen edhe në të ardhmen...”, - u shpreh gjeneralmajor Begaj.

Duke vënë theksin te synimi i Shtabit të Përgjithshëm për vijimin e punës për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak, për të bërë të mundur arritjen e standardeve dhe misionit të batalioneve dhe Forcës Tokësore, gjeneralmajor Begaj siguroi komandantin e Batalionit të Parë të Këmbësorisë, nënkolonel Ali Mali dhe efektivët e batalionit, se vëmendja dhe mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm për këtë batalion nuk do të mungojë.

SEDM, një sukses i bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes

Në kuadër të Procesit të SEDM-së, i cili kryesohet nga Shqipëria për periudhën 2019-2021, në Ministrinë e Mbrojtjes, nëpërmjet një videokonference (VTC), u zhvilluan Takimi i 44-të i Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe Takimi i 45-të i Komitetit Drejtues Politik-Usharak/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (PMSC/MPFSEE).

Këto dy takime u realizuan me mbështetjen e portalit të SEDM-së, me anë të VTC, si rezultat i situatës aktuale të krijuar nga pandemia. Përfaqësues nga 14 vende anëtare të SEDM-së (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina dhe Gjeorgjia), komandanti i Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG HQ) si dhe vëzhgues nga organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, respektivisht UNDP SEESAC dhe RACVIAC, morën pjesë në këto takime, që u drejtuan nga drejtori i Sekretariatit të SEDM-CC/PMSC, z. Gjergji Methoxha. Zoti Methoxha theksoi në fjalën e tij se procesi i SEDM-së, si procesi i angazhimit të vendeve të Evropës Juglindore në nivel ministerial, ka treguar në gjithë këto vite se është një sukses i bashkëpunimit dhe integritetit rajonal në fushën e mbrojtjes, duke forcuar lidhjet e bashkëpunimit dhe bashkëveprimin ndërmjet vendeve të SEDM dhe duke kontribuar në të mirë të paqes dhe stabilitetit rajonal. Në takimin e SEDM-CC u diskutuan zhvillimet mbi projektet në kuadër të SEDM, respektivisht mbi punën e bërë mbi projektin për



Morën pjesë 14 vende anëtare të SEDM-së: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina dhe Gjeorgjia, komandanti i Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG HQ), etj.



ndërlidhjen e spitaleve ushtarake ("Interconnection of Military Hospitals Project"), mbi promovimin e lidereve femra, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ("Female Leaders in Security and Defense (FLSD) Project") si dhe në zhvillimin e mëtejshëm të Portalit të SEDM ("SEDM Permanent Portal"). Në takimin e PMSC-së, u diskutuan çështjet lidhur me zhvillimin e kapaciteteve dhe

angazhimeve të SEEBRIG/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore si dhe u morën vendime për të gjitha çështjet që lidhen me aktivitetet e ardhshme të Brigadës në kuadër të bashkëpunimit në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale. Në klimën e bashkëpunimit vendet shprehën vullnet dhe vendosmëri për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal.

Shqipëri-Maqedonia e Veriut:

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes do të vazhdojë

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi takohet me homologun maqedonas Bashkim Hasani

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi ka zhvilluar një takim në Tiranë, me homologun e tij, zëvendësministrit e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bashkim Hasani.

Në takim u diskutua për bashkëpunimin e mbrojtjes dhe zbatimin e Planit për Bashkëpunimin të Ndërsjellë në Mbrojtje, midis dy

vendeve-aleatëve të Aleancës së NATO-s i cili u nënshkrua në janar të këtij viti. Zëvendësministri Hasani në takim ka falënderuar mbështetjen e Shqipërisë për anëtarësimin në Aleancë dhe shtoi se bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e Mbrojtjes, kontributi i përbashkët në misionin e paqes "Mbështetje e Vendorsur", si dhe

pjesëmarrja në trajnime e stërvitje duhet të vazhdojnë dhe të intensifikohen.

Bashkëpunimi midis ministrive të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut ka filluar në vitin 2004 dhe zhvillohet e realizohet në bazë të Planit për Bashkëpunim të Ndërsjellë në fusha të ndryshme të Mbrojtjes.

Modernizim i armatimit luftarak në Batalionin e Mbështetjes me Luftim

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH mori pjesë në rreshtimin organik të Batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcës Tokësore

Në kuadër të rishtrukturimit të Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në mjediset e Repartit Ushtarak 1060, më 12 mars 2021, në ceremoninë e rreshtimit organik të Batalionit të Mbështetjes me Luftim.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj u shpreh se organizimi i Forcave të Armatosura synon jo vetëm rritjen e efikasitetit operacional, por edhe një reformim të mëtejshëm të forcës ushtarake të vendit, bazuar edhe në mësimet e nxjerra si vend anëtar i Aleancës së NATO-s dhe kontribues në misionet e operacionet e saj. "Shtabi i Përgjithshëm synon vijimin e punës për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak të Batalionit të Mbështetjes me Luftim. Tashmë, efektivë të Kompanisë së Xhenios kanë filluar kurset EOD, duke synuar krijimin e kësaj ekspertize edhe brenda Forcës Tokësore, me qëllim mbështetjen e misionit të saj, si dhe kontributin e mundshëm përtej kufijve të Shqipërisë në të ardhmen...", theksoi gjeneralmajor Begaj.

Në përfundim të ceremonisë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, siguroi komandantin e Batalionit të Mbështetjes me Luftim, kolonel Petrit Dajlanin dhe efektivët e batalionit, për mbështetjen e tij dhe Shtabit të Përgjithshëm në arritjen e standarteve dhe objektivave të caktuara. Komandanti i Batalionit të Mbështetjes me Luftim, kolonel Petrit Dajlani, falënderoi shefin e



Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantin e Forcës Tokësore për praninë e tyre në këtë ceremoni. Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për Batalionin e Mbështetjes me Luftim.

Batalioni i Mbështetjes me Luftim krijon një kapacitet ushtarak të veçantë me një mision dhe detyra specifike për mbështetjen me zjarr, operacione xheniere dhe mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë të reparteve të manovrës së Forcës Tokësore. Në përfundim të ceremonisë shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe të ftuarit ndoqën nga afër një demonstrim të përgatitur nga efektivët e këtij batalioni.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe komandanti i Regjimentit të

Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj u shpreh se organizimi i Forcave të Armatosura synon jo vetëm rritjen e efikasitetit operacional, por edhe një reformim të mëtejshëm të forcës ushtarake të vendit, bazuar edhe në mësimet e nxjerra si vend anëtar i Aleancës së NATO-s dhe kontribues në misionet e operacionet e saj. "Shtabi i Përgjithshëm synon vijimin e punës për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak të Batalionit të Mbështetjes me Luftim. Tashmë, efektivë të Kompanisë së Xhenios kanë filluar kurset EOD, duke synuar krijimin e kësaj ekspertize edhe brenda Forcës Tokësore, me qëllim mbështetjen e misionit të saj, si dhe kontributin e mundshëm përtej kufijve të Shqipërisë në të ardhmen...", theksoi gjeneralmajor Begaj.

Më 24 mars 2021, u nënshkruhet në Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë "Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e Mjekësisë Ushtarake".

Protokolli u nënshkrua nga zoti Florian Kali, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe kolonel Muhammet Kelami Kablay, atashe ushtarak i Turqisë në Tiranë.

Procesi u finalizua pas një periudhe intensive negocimi. Kjo marrëveshje i vjen në ndihmë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë pasi pala turke merr përsipër kurimin falas në institucionet mjekësore ushtarake të anëtarëve aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura dhe familjarëve të tyre, personelit në rezervë dhe pension të Forcave të Armatosura dhe personelit civil që punon në Ministrinë e Mbrojtjes

Nënshkruhet marrëveshja për trajtimin mjekësor të ushtarakëve shqiptarë në Turqi

Protokolli u nënshkrua nga zoti Florian Kali, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes dhe kolonel Muhammet Kelami Kablay, atashe ushtarak i Turqisë në Tiranë



dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Protokolli rregullon trajtimin e studentëve ushtarakë shqiptarë, të cilët studiojnë për mjekësi në Turqi,

me bursa falas, si dhe parashikon kurse dhe specializime për rritjen e tyre profesionale. Palët angazhohen për implementimin sa më parë të këtij protokoli.

Gjeneralmajor Bajram Begaj-ambasadori i Spanjës Marcos Alonso

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, zhvilloi më 25 mars 2021, një takim pune me ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në vendin tonë, z. Marcos Alonso. Në këtë takim u diskutua për situatën e sigurisë në rajon e më gjerë dhe u vlerësua roli i NATO-s, si një faktor stabiliteti për rajonin e Ballkanit. Si vende anëtare të NATO-s, forcat e armatosura të dy vendeve, punojnë e shërbejnë krah për krah që nga Afganistani i largët e deri në strukturat komanduese e të forcës së NATO-s. Gjeneralmajor Begaj i shprehu ambasadorit Alonso falënderimet për rolin dhe asistencën e Spanjës gjatë procesit të transformimit të FARSH dhe integritit të plotë në strukturat e Aleancës së NATO. Ndërsa, ambasadori i Spanjës, z. Alonso, vlerësoi bashkëpunimin ndër vite midis dy vendeve dhe shprehu gatishmërinë

Spanja ka kontribut në transformimin e FARSH në strukturat e NATO-s

Gjeneralmajor Bajram Begaj, priti në takim ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në vendin tonë, z. Marcos Alonso



për rritjen e bashkëpunimit ushtarak gjatë periudhës së tij në detyrë. Në përfundim gjeneralmajor Begaj i uroi ambasadorit suksese në detyrën e re dhe e siguroi mbi gatishmërinë e FARSH për të rritur

nivelin e bashkëpunimit dy-palësh në fushën e mbrojtjes duke eksploruar mundësitë e ofruara. Z. Marcos Alonso mori detyrën e Ambasadorit të Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri në muajin tetor 2020.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi më 30 mars, një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Kroacisë, kolonel Marijana Pleša Čadonić, në kuadër të përfundimit të mandatit të atasheut ushtarak jo rezident në Tiranë.

Gjeneralmajor Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal në veçanti bashkëpunimin në kuadër të kartës së Adriatikut (A5) por edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktivitetëve të NATO.

Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet në fushën e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve si edhe misionëve të NATO. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan Kursin e Lartë për Siguri dhe Mbrojtje, të zhvilluar nga Akademia e Forcave të Armatosura të RSH, ku marrin pjesë edhe ushtarakë të lartë të Kroacisë.

Në përfundim të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj,

BASHKËPUNIMI USHTARAK ME KROACINË

“Certifikatë Vlerësimi” për atasheun kroat, kolonel Marijana Pleša



Gjeneralmajor Bajram Begaj, priti atasheun ushtarak të Republikës së Kroacisë, kolonel Marijana Pleša Čadonić



pasi vlerësoi bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë gjatë mandatit të atasheut ushtarak jo rezident, në Tiranë, i akordoi kolonel Marijana Pleša, “Certifikatë Vlerësimi”, me motivacionin: “Për kontributin e veçantë për zgjerimin e bashkëpunimit ushtarak midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Kroacisë”.

Ekipi amerikan takohet me gjeneralmajor Bajram Begaj

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua, më 29 mars 2021, takimi me ekipin nga USEUCOM, përgjegjëse për implementimin e projektit për ndërtimin e Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike QOSK/CCARC të Forcave të Armatosura dhe të përfaqësuesve të korporatës General Dynamics Information Technology (GDIT), nënkontraktor i USEUCOM-it. Ngjitja e Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike (QOSK), si pjesë përbërëse e Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, ka si qëllim menaxhimin e sistemeve të sigurisë kibernetike që do të mbikëqyrin/monitrojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI) të Forcave të Armatosura. Personeli i Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike e njohu ekipin me anën ligjore të Sigurisë Kibernetike në vendin tonë duke i shpjeguar detyrimet e ligjit 2/17 për Sigurinë Kibernetike, Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe objektivat e saj dhe Strategjinë e Mbrojtjes Kibernetike të MM-së 2021-2023. Më pas u mbajt një briefing njohës mbi ngritjen, organizimin dhe funksion-

Qendra e Sigurisë Kibernetike në mbrojtje të informacionit në FA dhe në kuadër të NATO-s

Ndërtimi i Qendrës Operacionale të Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike do të bëjë të mundur që sistemet në FA të jenë më të sigurta, më të mbrojtura dhe informacioni i shkëmbyer në FA, por dhe në kuadër të NATO-s, do të jetë më i besueshëm

imin e Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike (NJUSK), si Elementi Përgjegjës i Sigurisë Kibernetike të Forcave të Armatosura, bazuar në urdhrin e kryeministrit nr. 76, datë 10.06.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010, të kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”. Ekipi amerikan u prit edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, i cili theksoi rëndësinë e ngritjes dhe ndërtimi i Qendrës Operacionale të Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, i cili do të bëjë të mundur që sistemet në FA do të jenë më të sigurta, më të mbrojtura dhe informacioni i shkëmbyer në FA, por dhe në kuadër të NATO-s do

të jetë më i besueshëm. FA zotërojnë sisteme e pajisje të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat bëjnë të mundur rritjen e operabilitetit të Forcave të Armatosura dhe lehtësimin e punëve të përditshme të përdoruesve civilë dhe ushtarakë të FA-së. Një prej sfidave aktuale dhe të vazhdueshme për të gjitha vendet, është ndërtimi i një shoqërie të zhvilluar digjitale dhe të mbrojtur kibernetikisht, të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, për të maksimizuar përfitimet dhe për të menaxhuar rreziqet. Hapësira Kibernetike në Samitin e NATO-s, Varshavë 2016, është njohur si fusha/domain-i i pestë i luftës së bashku me tokën, detin, ajrin dhe hapësirën. Vendi ynë njeh hapësirën kibernetike si fushën e pestë të luftës.



Njohja me sfidat e së ardhmes së Forcave Ajrore të NATO-s

Kolonel Ylli Pulaj në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, mori pjesë në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, "NATO Air Chiefs' Symposium (NACS) 2021", i cili u zhvillua me video-konferencë. Ky ishte takimi i parë i komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere për vitin 2021, ku morën pjesë 30 shefa të Forcave Ajrore.

Konferenca nga Ramstein, Gjermani, u zhvillua nën drejtimin e gjeneral Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën dhe kishte si qëllim diskutimin mbi situatën aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes, njohja me sfidat e së ardhmes së Forcave Ajrore të NATO-s.

Takimi i Komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, është një aktivitet periodik, i organizuar nga Komanda Ajrore e Aleancës, Ramstein, Gjermani, i cili zhvillohet në kuadër të takimeve vjetore të komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga strukturat e NATO-s, që ndjekin çështjet e Forcave Ajrore



Konferenca u zhvillua nën drejtimin e Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën

si Agjencia e Komunikimit e NATO-s (NCIA) dhe Qendrat e Operacioneve Ajrore të Kombinuara (CAOC). Takimi u përshëndet edhe nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshalli Sir Stuart Peach, i cili mbajti fjalimin kryesor mbi NATO-2030, "Përshtatja dhe Sfidat e së Ardhmes".

Gjeneral Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, tha se: "Këtë vit, ne po punojmë shumë për rritjen e Qendrës Hapësinore të NATO-s, avancimin e aktiviteteve të përbashkëta të trajnimit dhe sinkronizimin e ndarjes së inteligjencës për të konkurruar me kundërshtarët tanë. Duke parë nga e ardhmja, siguria e Aleancës kërkon përpjekje të mëtijshme inovative, si modernizimin e arkiteturës taktike të lidhjes së të dhënave të Aleancës dhe punën për ofrimin e trajnimeve reale të kundërshtarëve të drejtpërdrejtë". shtoi gjenerali Harrigian.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshalli Sir Stuart Peach tha se: "Ky vit shënon gjashtëdhjetë vjet, që NATO realizon misione të policimit ajror për të mbajtur qiellin tonë të sigurt. Ne jemi duke investuar në të ardhmen përmes blerjes së Sistemit të Mbrojtjes Tokësore, modernizimin e flotës të avionëve të Sistemit të Paralajmërimit dhe Kontrollit Ajror dhe blerjen e kapacitetit satelitor me vlerë mbi 1 miliard euro në 2020-2034".

Pjesëmarrësit diskutuan mbi aktivitetet e Zbatimit të Hapësirës së NATO-s me theks të veçantë koordinimin operacional të aseteve hapësinore Aleate. Për më tepër, diskutimet përfshinin iniciativë shumëkombëshe që sigurojnë Mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike duke përfshirë përparimin e vazhdueshëm të integritetit të avionëve të gjeneratës së katërt dhe të pestë, operacione dhe role të vazhdueshme të kontrollit ajror nga rritja e inventarëve të Aleatëve në teatrin Evropian.

Profesionalizëm nga vajzat dhe gratë në strukturat e Forcës Ajrore

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, Rinas, u zhvillua takimi i zëvendëskomandantit, kolonel Ylli Pulaj me përfaqësuese të personelit femër në uniformë dhe ato civile të strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit.

Kolonel Pulaj, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi se ky takim njohës merr një vlerë të veçantë pasi realizohet menjëherë mbas ditës ndërkombëtare të grave dhe me këtë rast ai uroi të pranishmet për festën dhe falënderoi vajzat dhe gratë në uniformë duke përfshirë këtu edhe punonjëset civile për kontributin e tyre në Forcën Ajrore.

Gjithashtu zëvendëskomandanti, ndërmjet të tjerash, përcolli mesazhin se prania dhe puna e vajzave e grave në uniformë dhe atyre civile në strukturat e Forcës Ajrore është për t'u vlerësuar për korrektësinë, dedikimin dhe përkushtimin që ato tregojnë çdo ditë me profesional-

Zëvendëskomandanti i Forcave Ajrore, kolonel Ylli Pulaj takohet me përfaqësuese të personelit femër në uniformë dhe ato civile, pjesë e strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit



izmin e tyre.

Në përfundim të fjalës së tij, kolonel Pulaj uroi shëndet për të gjithë vajzat e gratë në uniformë, punonjëset civile dhe familjet e tyre, pasi shëndeti, theksoi ai, merr

rëndësi më shumë në këtë kohë pandemie si dhe në të njëjtën kohë i siguroi ato se, do të punojmë të gjithë së bashku për të përmbushur me sukses detyrat dhe për të çuar përpara Forcën Ajrore.

Piloti i Bazës Ajrore Farkë

Piloti i Bazës Ajrore Farkë, nëntoger Fabio Bardho, ka zhvilluar më datë 25 mars 2021, fluturimin e tij të parë me helikopter AB 206 në mënyrë autonome, pas një periudhe të gjatë trajnimit teorik dhe praktik me instruktorë dhe pilotë me eksperiencë të kësaj baze.

Nëntogeri Bardho ka kryer studimet në Akademinë e Forcave Ajrore Italiane dhe është diplomuar në vitin 2020. Ai gjatë periudhës së arsimit dhe trajnimit ka zhvilluar fluturime me avion SF260. Aktualisht ai është me detyrë pilot në Bazën Ajrore Farkë dhe si çdo pilot që aftësohet dhe familjarizohet me mjetet e fluturimit, edhe nëntoger Bardho është vlerësuar tashmë i aftë dhe i gatshëm të zhvillojë fluturime i vetëm pa asistencën e instruktorëve të tij në kabinën e helikopterit. Çdo fluturim i parë konsiderohet një ngjarje e shënuar në karrierën e pilotëve, prandaj këtë zhvillim

Nëntoger Bardho në fluturimin e tij të parë me helikopter AB 206

Nëntogeri Fabio Bardho ka kryer studimet në Akademinë e Forcave Ajrore Italiane dhe është diplomuar në vitin 2020

fluturimi të pilotit Fabio Bardho e kanë asistuar edhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, komandanti i Bazës Ajrore Farkë, nënkolonel Julian Dulemata si dhe kolegë dhe stafi i Forcës Ajrore.

Në fund të fluturimit piloti Bardho u duartrokoi e u përgëzua nga kolegët dhe drejtuesi i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj i cili më pas u takua edhe me kursantët që po përgatiten për pilotë të ardhshëm të Forcës Ajrore, të cilët i inkurajoi dhe i uroi mbarësi në rrugën e tyre të pilotimit.



Anijet e Forcës Detare “Oriku” dhe “Lissus”

Zhvillohet stërvitja e përbashkët me anijen e Flotës 6-të të SHBA “USS Monterey”

Kapiteni i “USS Monterey” Joseph Baggett: “Përmes operacioneve dhe trajnimeve të tilla si ky, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj përmirësojnë marrëdhëniet ekzistuese të bashkëpunimit”

Anijet shqiptare dhe amerikane kanë zhvilluar manovra detare të përbashkëta në brigjet e vendit tonë, një bashkëpunim që dëshmon qartë nivelin koordinimin dypalësh.

Në datën 29 mars 2021, u zhvillua stërvitja detare ndërmjet anijes së Flotës së 6-të të SHBA “USS Monterey” dhe anijeve të Forcës Detare, “Oriku” dhe “Lissus”, e cila u realizua në ujërat e brigjeve shqiptare.

“Dy anije patrullimi shqiptare të klasës Iliria (ALS Oriku dhe ALS Lissus) dhe anija amerikane USS Monterey ekzekutojnë manovra detare të thjeshta dhe të përparuara në brigjet e Shqipërisë”, ka njoftuar ambasada e SHBA në Tiranë. Misioni diplomatik amerikan sqaroi se të gjitha procedurat dhe manovrat janë kryer në përputhje me standardet e NATO-s. Sipas ambasadës, ky

trajnim tregon rritjen e koordinimit dhe ndërveprimit dypalësh midis dy flotave, asaj shqiptare dhe amerikane.

Ky trajnim tregon rritjen e koordinimit dhe ndërveprimit dypalësh midis dy flotave tona. “Përmes operacioneve dhe trajnimeve të tilla si ky, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj përmirësojnë marrëdhëniet ekzistuese të bashkëpunimit dhe ndërmarrin hapa të mëdhenj në ruajtjen e lidhjes jetike të rajonit me ekonominë globale”, tha Kapiteni i “USS Monterey” Joseph Baggett.

Sipas Forcave Detare Shqiptare “Gjatë stërvitjes u përpunuan elementë të manovrimit taktik si të thjeshtë po ashtu edhe të avancuar. Gjithashtu stërvitja u zhvillua dhe në mbrojtjen kundra sulmeve e mjeteve të vogla dhe të shpejtë njëkohësisht. Stërvitja përfundoi me sukses dhe u zhvillua sipas procedurave të NATO-s”.



Anija franceze (BSAM) Loire zhvillon vizitë në Portin Detar Vlorë

Anija e klasit Loire A-602, është e gjatë 70,3 metra dhe ka një tonazh rreth 2960 ton

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Francën, nga data 7-10 mars 2021 anija franceze e klasit Loire (BSAM-Bâtiments de Soutien et d'Assistance Métropolitains) ka zhvilluar vizitë në Portin Detar Vlorë dhe në bazën detare në Pashaliman. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe njohja me metodat e reja luftarake detare. Anija franceze u prit në port nga shefi i Shtabit të Flotiljes Detare, kapiten i rangut III Ilir Çobo, atasheu ushtarak francez, kolonel Fabrice Duda dhe kuadro të Flotiljes Detare.

Pas bregëzimit dhe urimit të mirëseardhjes nga pala shqiptare, komandanti i anijes kapiten i rangut III Thomas Chabous ftoi në bordin e anijes komandantin e Flotiljes Detare, kapiten i rangut II Sabri Gjinollari, ku e njohu ata me misionin dhe detyrat që kryen anija e klasit Loire.

Anija u vizitua gjithashtu nga ambasadorja franceze Elisabeth



Barsacq, atasheu ushtarak kolonel Fabrice Duda në vendin tonë, të cilët së bashku me komandantin e anijes vijuan vizitën në bashki, si dhe bazën detare në Pashaliman. Në bashki ata u pritën nga kryetari i saj Dritan Leli, i cili i njohu me qytetin dhe potencialin turistik të tij.

Në vizitën e tyre në bazën detare

në Pashaliman ata u pritën nga komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari dhe oficerë të shtabit. Miqtë francezë u njohën me strukturën, misionin, zhvillimin dhe modernizimin e deritanishëm të Forcës Detare. Anija e klasit Loire A-602, është e gjatë 70,3 metra dhe ka një tonazh rreth 2960 ton. Ajo u largua nga vendi ynë më datë 10 mars 2021.

Anijet e klasës Loire ose të ndihmës metropolitane (BSAM), të quajtura anije të ndihmës dhe det të hapur (BSAH) është një anije mbështetëse për Marinën Franceze, e prodhuar nga "Kership", një ndërmarrje e përbashkët e krijuar në 2013 nga Piriou (55%) dhe DCNS (45%).

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit me specialitet Detari, i cili zgjati 8 javë. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe komandanti i Flotiljes Detare, kapiteni rangut të dytë Sabri Gjinollari. Komandanti i Qendrës Stërvitore Pashaliman, kapiteni rangut të dytë Bimir Likaj, personelit të sapo certifikuar i uroi suksese dhe dijet e marra t'i përdorin në të ardhmen në repartet e tyre.

Faza e dytë pati gërshetim teorik, por kryesisht janë përqendruar në veprime praktike, të cilat u zhvilluan edhe në det, sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e

Përfundon kursi Bazë i Nënoficerit për specialitetin Detari

Kursi Bazë i Nënoficerit me specialitet Detari ka zgjatur 8 javë

këtij kursi u njohën gjerësisht me tema që përfshijnë njohjen e bregdetit shqiptar, sigurinë hidro-lundrimore, luftën kundër ujit dhe zjarrit në anije, shpëtimin e njeriut në det në kushte të ndryshme të motit dhe detit. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm. Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët dhe një foto të përbashkët.



Të ndjekësh nga Tirana një aksident ajror në Oqeanin Atlantik

HAJRIE DEDAJ

Argjentina dhe Uruguaj ishin vendet që organizuan konferencën "SAREX-Argjentina SAR", në të cilën kishin ftuar për të qënë pjesëmarrëse edhe Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, strukturë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Pas ftesës së drejtuesve të stërvitjes, personeli i Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, nën drejtimin e kryetarit të kësaj qendre kolonel Fiqiri Hoxha, më datën 26.03.2021, ndoqën virtualisht stërvitjen e përbashkët SAREX-Argjentina SAR, së bashku me mbi 90 vende të tjera pjesëmarrëse.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte testimi i sistemeve aeronautike SAR të Argjentinës dhe Uruguajt në koordinim me sistemin SAR detar, për të menaxhuar një aksident ajror të simuluar, në Oqeanin Atlantik. Në stërvitje u përfshinë të gjitha nivelet e shërbimit SAR të këtyre vendeve.

Objektivi kryesor i stërvitjes ishte zhvillimi i kapaciteteve të koordinimit dhe bashkëpunimit SAR, në Argjentinë dhe Uruguaj, së bashku me agjencitë e përfshira në një ngjarje në një mjedis detar.

Objektiva specifike të stërvitjes ishin: testimi dhe vënia në praktikë e të gjitha Procedurave Standarde Operacionale (PSO-ve); gatishmëria dhe



Stërvitja u ndoq virtualisht nga më shumë se 90 vende pjesëmarrëse, midis të cilave edhe Shqipëria. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte testimi i sistemeve aeronautike SAR të Argjentinës dhe Uruguajt në koordinim me sistemin SAR detar për të menaxhuar një aksident ajror në Oqeanin Atlantik



përgatitja e agjencive pjesëmarrëse; identifikimi i fushave problematike që mund të kenë nevojë të adresohen në nivele të ndryshme; testimi dhe përdorimi i kapaciteteve aktuale të koordinimit në një mjedis operimi si dhe mundësia e stafit operacional për të azhurnuar dhe praktikuar aftësitë e kërkimit dhe shpëtimit.

Në stërvitje morën pjesë strukturat Aeronautike SAR të Argjentinës, strukturat Aeronautike SAR të Uruguajt, strukturat Detare SAR të Argjentinës, Forcat Detare të Argjentinës, Forcat Ajrore Argjen-

tinase dhe njësitë vendore detare të Argjentinës.

Skenari i stërvitjes parashikonte një aeroplan bombardues BD-700 me 12 persona dhe tre anëtarë të ekuipazhit, lëshon një MAYDAY për shkak të dëmtimit katastrofik në dy motorët e tij dhe përgatitet të kryejë një ulje në Oqeanin Atlantik, disa miljenga bregu Argjentinës.

Strukturat pjesëmarrëse në stërvitje planifikuan dhe organizuan operacionin e kërkim shpëtimit të të dëmtuarve dhe të mbijetuarve duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm,

që nga deklarimi i emergjencës, vlerësimi i situatës, shpallja e fazës së emergjencës, identifikimi i të gjitha agjencive që mund të jenë të nevojshme për t'iu përgjigjur skenarit, grumbullimi i informacioneve nga burime të ndryshme dhe vlerësimi i tyre, planifikimi i kërkimit duke e pasqyruar edhe në hartë, koordinimi me anijet pranë zonës, dërgimi i njërive të kërkimit, organizimi i kërkimit dhe gjetja e objektit të kërkimit e cila shënon edhe përfundimin e stërvitjes.

Stërvitja u ndoq virtualisht nga më shumë se 90 vende pjesëmarrëse, midis të cilave edhe Shqipëria (QKKSH) për të cilën pati një falënderim nga moderatorin e stërvitjes në fillim të saj.

Në përfundim të stërvitjes, Kryetari i QKKSH, kolonel Fiqiri Hoxha, tha për Gazetën "Ushtria" se ndjekja virtuale e kësaj stërvitje, ishte një eksperiencë e shtuar për personelin e Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, si në drejtim të planëzimit të stërvitjeve të përbashkëta SAREX, ashtu edhe në drejtim të koordinimit të operacioneve të kërkim shpëtimit në rastet e aksidenteve ajrore e detare.

Gjatë ndjekjes së kësaj stërvitje ra në sy zbatimi me korrektësi i Procedurave Standarde Operacionale, të parashikuara në manualin IAMSAR, funksionimi perfekt i mjeteve të komunikimit, grumbullimi dhe përpunimi i informacionit në një qendër të vetme, vlerësimi i situatës dhe angazhimi në kohë i kapaciteteve operacionale. Bie në sy ngritja e qendrave moderne të kërkim shpëtimit, të kompletuara me pajisje të kohës, të digjitalizuara dhe mjaft efektive për një evidentim, vlerësim e veprim të shpejtë e të saktë.

Megjithëse stërvitja ishte e parapërgatitur, ra në sy niveli i lartë profesional i personelit pjesëmarrës në stërvitje, disiplina e lartë, qetësia dhe kompetenca në komunikim dhe në pasqyrimin e situatës, koordinimin e operacionit.

Duke ndjekur virtualisht këtë stërvitje dalim në konkluzion se ushtrimet stërvitore SAR janë mjaft të domosdoshme. Ato testojnë dhe përmirësojnë planet operacionale, sigurojnë përvojë mësimore dhe

përmirësojnë aftësitë koordinuese dhe bashkërenduese. Ushtrimet, të kryera sa më reale, ndihmojnë për të demonstruar dhe vlerësuar efektivitetin e vërtetë të trajnimit, efikasitetin operacional dhe kompetencën e shërbimit SAR. Ushtrimet stërvitore zbulojnë mangësitë që mund të ekzistojnë në planet e SAR-it dhe u mundësojnë atyre të përmirësohen. Është më e sigurt të zbulohen të meta nga ushtrimet stërvitore dhe jo në operacionet reale. Mjaft të vlefshme janë edhe stërvitjet e përbashkëta midis shteteve fqinje, ose palëve në marrëveshjet e SAR-it.

"Ndjekja virtuale e kësaj stërvitje, ishte një ndihmesë e madhe,

për Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit në kuadrin e përgatitjes dhe pjesëmarrjes në stërvitjen e përbashkët "Defender Europe 21", që do të zhvillohet në vendin tonë në periudhën 26 prill-20 qershor 2021", -u shpreh nënkolonel Vasil Taçi, nënkryetar i Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit. Ndjekja virtuale e kësaj stërvitje u realizua falë mbështetjes dhe asistencës së specialistëve të Drejtorisë së Ndërlidhjes (J6), në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të cilat e mundësuan futjen në linkun e stërvitjes dhe mbarëvajtjen e saj gjatë të gjithë periudhës së zhvillimit të saj.

NË KOMANDËN E FORCËS AJRORE

Zhvillohet Konferenca Fillestare e Planëzimit "Ambicia e Shqiponjës"

Konferenca kishte si qëllim prezantimin e objektivave të stërvitjes, e cila parashikohet të zhvillohet në muajin korrik 2021

Në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua më 19 mars 2021, Konferenca Fillestare e Planëzimit "Ambicia e Shqiponjës" me pjesëmarrjen e shtabit të Forcës Ajrore, personelit të Qendrës së Kontroll-Raportimit, si dhe përfaqësues të Bazës Ajrore Farkë.

Shefi i Shtabit të Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli në fjalën e tij prezantoi qëllimin dhe objektivat e stërvitjes, e cila parashikohet për t'u zhvilluar në muajin korrik 2021.



Kjo stërvitje ka si qëllim shfrytëzimin e kapaciteteve të postit të kontroll-raportimit "Control Reporting Post" të radarit dhe shndërrimi i saj në qendër operacionale ajrore "Control Reporting Center" të Forcës

Ajrore dhe/ose qendër e operacioneve ajrore të një komponenti Ajror.

Konferenca përfundoi me diskutimet e secilit aktor në stërvitje, duke i vënë theksin kalendarit dhe specifikimeve të stërvitjes si dhe u përgatit drafti i parë i planëzimit të stërvitjes. Më pas, nga përfaqësuesi i degës së operacioneve të Forcës Ajrore u prezantua skenari i stërvitjes dhe fazat e saj, të cilat do të vijojnë me procesin e planëzimit të moduleve të stërvitjeve.

INTEGRIMI I GRAVE NË FA

Barazia gjinore, një sfidë për t'u adresuar

Major MA. LORENA PAPA
Specialiste për bashkëpunimin me
NATO. Drejtorja e J-5/8, SHP

Integrimi i grave në strukturat ushtarake meriton vëmendje të shtuar dhe mundësi të barabarta përgjatë të gjithë linjës së komandimit dhe niveleve të përgjegjësisë në Forcat e Armatosura. Vitet e fundit, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm kanë ndërmarrë hapa me vlerë në kuadrin e procesit të rekrutimit dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në FARSH. Pavarësisht se kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, përsëri ekzistojnë problematika në barazinë gjinore, kryesisht në mundësitë që ju ofrohen grave me uniformë në përparimin e tyre të mëtejshëm në karrierën ushtarake. Niveli i ulët i përfaqësimit të grave në pozicione vendimmarrëse dhe komanduese, si dhe mospërfshirja e tyre në detyra specifike (combat mision), janë indikatorë të rëndësishëm që tregojnë rëndësinë e implementimit të politikave të reja, të cilat mbështesin integrimin e grave në të gjitha sferat e veprimtarisë së Forcave të Armatosura, veçanërisht të politikave që ofrojnë mundësi të barabarta dhe gjithë përfshirje. Në këtë kuadër është shumë e rëndësishme të ndryshohet mendësia "dominuese mashkullore" dhe të kultivohet sjellja e pranimit dhe barazia gjinore, gjë që rrit angazhimin, por edhe kontributin e grave në Forcat e Armatosura. Inkurajimi i grave në angazhime operacionale, përfshirja në procesin e garimit si të barabarta me burrat dhe sigurimi i eksperiencave të vlefshme drejtuese, do të rrisë shanset e përpërparimit në karrierë, duke arritur në këtë mënyrë potencialin e plotë për përfitimin mbi bazën e barazisë gjinore brenda FARSH.

Problematikat e mësipërme janë trajtuar gjerësisht në forume dhe aktivitete të ndryshme, por në vijimësi do të përqendrohemi tek disa aspekte teorike të barazisë gjinore të fituara nga eksperiencia personale në FARSH por edhe nga njohuritë e marra në institucionet arsimore përëndimore.



Politikat e implementuara në mbështetje të integrimit gjinor

Përgjatë dekadave të fundit ka një ndryshim pozitiv në lidhje me rolin e grave në shoqërinë shqiptare në lidhje me barazinë në sfera të ndryshme të jetës politike, sociale, ekonomike, etj. Politika të veçanta janë aplikuar nga qeveria në lidhje me implementimin e perspektivës gjinore në institucionet shqiptare duke përfshirë edhe FARSH.

"Ligji mbi Barazinë Gjinore në Shoqëri" në vitin 2008, kërkonte nga qeveria dhe institucionet e tjera publike të siguronin parimet e

mbrojtjes së mjaftueshme nga diskriminimi gjinor dhe të garantonte mbështetje për barazinë gjinore në shoqëri. Implementimi i këtij ligji solli miratimin e "Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2011-2015".

Për sa i përket Forcave të Armatosura, kjo strategji inkurajonte zhvillimin e politikave gjinore dhe shanseve të barabarta për gratë në pozicione vendimmarrëse/komanduese si dhe në misionet paqëruajtëse. Në shkurt të vitit 2011, gratë ushtarake shqiptare themeluan shoqatën "Gratë në Forcat e Armatosura të Republikës

së Shqipërisë". Ndër objektivat kryesorë të organizatës ishin mbështetja e përparimit të grave në karrierën ushtarake si dhe implementimi i rezolutës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" në FARSH. Themelimi i Sektorit të Mundësive/Shanseve të barabarta në Qendrën e Personel Rekrutimit në vitin 2012, do të mbështeste më tej promovimin e barazisë dhe ofrimin e shanseve të barabartanë rekrutimin e burrave dhe grave si dhe monitorimin e politikave të ndryshme në barazinë gjinore.

"Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit mbi Barazinë Gjinore 2016-2020" ka për qëllim të eliminojë diskriminimin mbi baza gjinore, të fuqizojë rolin e vajzave dhe grave si dhe të garantojë pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrjen politike dhe publike. Nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rrjedhin nga kjo strategji, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, synojnë të arrijnë një nivel përfaqësimi prej 15 përqind të grave nën uniformë, si dhe të mbështesë promovimin e tyre nëgradë dhe karrierë.

Përgjatë procesit të pranimit të grave në Forcat tona të Armatosura, zyrtarisht që prej vitit 1967, (një arritje për t'u vlerësuar duke marrë në konsideratë se Akademia e West Point në SHBA ka pranuar studente gra vetëm në vitin 1975), është për t'u vlerësuar fakti që në vitin 2016 një oficer grua, Manushaqe Shehu, është promovuar në gradën e lartë "gjeneralbrigade". Ndërkohë në vitin 2020, numri total i grave ushtarake, që shërbenin në FARSH ishte 826 ose 14.1 përqind e numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak. Nga këto, 38 ushtarake mbanin pozicione komanduese si komandante dhe Zv. Komandante toge, dhe 5 oficerë ushtronin detyra drejtuese apo vendimmarrëse si Zv. Shef Shtabi, Drejtor/Zv. Drejtor Drejtorie, Zv. Atashe Ushtarak dhe Zv. Shef Shtabi Logjistik në KFOR. Megjithatë, përqindja që gratë zënë në numrin e përgjithshëm të personelit në FARSH (14.1 %) është për tu vlerësuar në raport me përqindjen që ato zënë në vendet anëtarë të NATO-s, sipas raportit të vitit 2018 përqindja shkon në 11.3%.

Ndikimi shoqëror në kulturën ushtarake

Duke qene se Forcat e Armatosura janë pjesë e shoqërisë ku jetojmë të gjitha ndryshimet në këtë organizatë janë edhe reflektime të

tendencës ndryshuese të shoqërisë. Një shoqëri shqiptare e dominuar ndër vite nga burrat, padyshim ka influencuar edhe në kulturën e përgjithshme në Forcat e Armatosura. Zbutja e ndikimit të kulturës mashkullore të jashtme do të vijojë të jetë një sfidë për FA. Kërkohej ndryshimi i mentalitetit brenda FA në interes të krijimit dhe zhvillimit të një klimë më e favorshme për barazinë gjinore pa dëmtuar kohezionin dhe efikasitetin operacional. Për të bërë ndryshime të qëndrueshme e afatgjata nevojitet mbështetje gjithëpërfshirëse, individuale, familjare, politike dhe e lidershipit ushtarak.

Pavarësisht dallimeve biologjike gjinore, të gjithë aftësitë e tjera si: etika në punë, kapacitetet intelektuale dhe drejtimi (lidershipi), forca, guximi dhe kurajo, janë elementë të cilët zhvillohen nëpërmjet eksperiencës, edukimit e trajnimit. Krijimi i shanseve të barabarta midis femrave dhe meshkujve në FA për të punuar, dhe për të fituar eksperiencën e nevojshme në funksione të rëndësishme nënjësitë operationale, do të mbështeste përparimin e grave në karrierë dhe integrimin e mëtejshëm të tyre në strukturat ushtarake. Edhe pse procesi i integritetit të grave në detyra specifike (combat mission) has në rezistencën e klimës mashkullore, ka ardhur koha për të bërë ndryshime graduale në këtë drejtim.

Në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, kam patur rastin të mbroj masterin shkencor në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në SHBA në vitin 2019 (<https://cgsc.contentdm.oclc.org/>). Me modesti do të rekomandoja që disa nga konkluzionet e këtij studimi të konsideroheshin nga lidershipi civil dhe ushtarak në FA si më poshtë:

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA duhet të të parashikojnë politika më të mira në lidhje me procesin e avancimit në karrierë të grave, si dhe mundësinë e emërimit në funksione të rëndësishme të cilat mundësojnë përparimin drejt gradave të larta dhe madhore njëloj si kolegët e tyre meshkuj. Përgatitja dhe promovimi i grave në funksione drejtuese do të shërbente si model suksesi (role model) për brezat e rinj, nëpërmjet të cilit do të kuptoheshin të mirat, pëfitimet por edhe përgjegjësitë e të qenit pjesë e strukturave ushtarake. Është e kuptueshme që brezat e rinj nuk dotë donin të angazhoheshin në

strukturat ushtarake, nëse ata do të shihnin këto struktura si limituese në të drejtat e tyre për zhvillim. Hartimi i dokumentave për barazinë gjinore do të mbetet gjithmone "në letër" nëse brezi i ri nuk sheh shembuj konkret suksesi të grave ushtarake në role vendimmarrëse; Institucionet arsimore ushtarake (Akademinë e Forcave të Armatosura), krahas të tjerash, duhet të adresojnë edhe sfidat komplekse të drejtimit dhe komandimit në FARSH, duke përfshirë në këtë proces edhe rolin e grave ushtarake. Nevojitet të përdoren materiale dhe burime të cilat do të ndikojnë në njohjen e realitetit dhe përmirësimin e klimës në njësitë ushtarake, e më tej ndërtimin e një kohezioni në njësitë ku burrat dhe gratë shërbejnë së bashku; Ngritja e një bordi këshillues për gratë në nivel strategjik (Shtabi i Përgjithshëm) i cili të orientojë dhe të monitorojë integrimin gjinor në FA. Parashikimi në strukturat operationale të FARSH i një pozicioni si këshillues gjinor do të ndikonte në aktivitetin e përditshëm, por edhe nivelin e pjesëmarrjes së grave si pjesë e operationeve që FA zhvillon në interes të paqes në botë; Organizimi në njësitë dhe repartet e FARSH e aktiviteteve specifike ku gratë ushtarake mund të shkëmbejnë eksperiencat dhe diskutojnë mbi sfidat që hasin në realitetin e përditshëm.

Nga kontigjenti i të rinjve dhe të rejave që FARSH rekruton sot do të dalin nënoficerët dhe oficerët e të nesërmes. Profesioni i ushtarakut, me kompleksitetin që e karakterizon, nuk mund të përballojë përjashtimin e 50 përqindëshit të gjeneratës së re dhe përsëri të ketë luksin të rekrutojë më të mirët që vendi ynë mund të ofrojë. Rekrutimi duhet të orientohej jo vetëm në rritje të përqindjes së grave në strukturat ushtarake, por edhe tek ofrimi i cilësive më të mira, edukimit dhe karrierës së barabartë për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë shqiptare, të cilët aspirojnë t'i shërbejnë atdheut.

Barazia gjinore nuk është një kocept i ri në shoqërinë njerëzore, por në kushtet aktuale mbetet një sfidë për tu adresuar, dhe ndoshta kësaj sfide do ti shkonte për shtat thënia e zgjuar e një zonje të njohur, si model i suksesit femëror, Margaret Thatcher: "If you want something said, ask a man; if you want something done, ask a woman."

INTERVISTA

Kërkim-shpëtimi, detyrimi ndërkombëtar dhe shtetëror shqiptar

Intervistë
me kryetarin
e Qendrës
Kombëtare
të Kërkim-
Shpëtimit,
kolonel
Fiqiri
Hoxha

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është një strukturë relativisht e re në Ministrinë e Mbrojtjes, por me një përgjegjësi të madhe shtetërore. Kjo për faktin se Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit(SAR) është një shërbim civil, por gjithashtu është struktura përgjegjëse për kërkim-shpëtimin në Republikën e Shqipërisë, domosdoshmëri për bashkëpunimin, komunikimin dhe koordinimin efektiv, që aktivizohet gjatë aksidenteve ajrore dhe detare kur jeta e njerëzve është në rrezik real. Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë është një shërbim i ngritur mbi bazën e konventave ndërkombëtare për

kërkim-shpëtimin, në të cilat Shqipëria aderon. Për të mësuar më tepër rreth kësaj qendre po sjellim në faqet e shtypit ushtarak intervistën me kolonel Fiqiri Hoxha, Kryetar i QKKSH.

Zoti Kolonel, ju keni kryer një sërë detyrash gjatë karrierës tuaj ushtarake, deri në mbërritje të detyrës aktuale, Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit. Para se të fillojmë këtë intervistë për gazetën “Ushtria”, mund të na thoni diçka për karrierën tuaj?

Ju faleminderit për këtë intervistë dhe për vëmendjen e shtypit ushtarak për Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit. Kam lindur në Elbasan në vitin 1969 dhe në vitin 1987 përfundova Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë dhe më pas kam kryer studimet në Fakultetin Gjitharmësh pranë Akademisë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë. Jam titulluar oficer aktiv në specialitetin “Këmbësori” në vitin 1991. Para se të merrja detyrën e kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, kam kryer detyrën e shefit të Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në Komandën e Forcës Tokësore. Gjatë karrierës sime ushtarake, kam shërbyer në pozicione të ndryshme në Forcat e Armatosura, si shef i Departamentit të Operacioneve në Akademinë e Forcave të Armatosura; atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë i akredituar në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Mal të Zi dhe në Bosnje-Hercegovinë; shef Shtabi në Policinë Ushtarake; komandant batalioni në Regjimentin Komando; shef i Degës së Zbulimit në Komandën e Forcës Tokësore; specialist i zbulimit taktik në Brigadën e Reagimit të Shpejtë, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Arma-



tosura. Kam ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Kam përfunduar Kursin e Lartë të Oficerit dhe Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Forcave të Armatosura; Kursin e Zbulimit Taktik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kursin Bazë të Oficerit në shkollën e Këmbësorisë në Turqi si dhe kurse të ndryshme funksionale. Kam kryer dy dislokime në misione ndërkombëtare, si përfaqësues i lartë ushtarak, pranë kontingjentit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Çad, dhe në Afganistan si oficer shtabi në Degën e Operacioneve dhe Stërvitjes në Komandën e Bashkuar të ISAF. Kam përfunduar "Masterin Shkencor në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes", pranë Akademisë Ushtarake "Skënderbej", Tiranë. Jam vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës ushtarake dhe flas rrjedhshëm gjuhën angleze dhe turke. Jam i martuar dhe kam dy fëmijë.

CV-ja juaj është shumë e pasur dhe me po kaq shumë detyra në strukturat e Forcave të Armatosura, si brenda dhe jashtë vendit. Si e shikoni detyrën aktuale të Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit?

Po. Gjatë karrierës time ushtarake, vërtet kam kryer detyra të shumta e mjaft të rëndësishme, por detyra aktuale e kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, është një detyrë ku unë ndjehem tepër i vlerësuar, është një detyrë me përgjegjësi kombëtare, detyrë që kërkon impenjim në çdo kohë, por edhe detyrë që të jep kënaqësi kur shikon se falë veprimit e koordinimit të shpejtë dhe në kohë nga struktura që drejton ke shpëtuar jetë njerëzish.

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është një strukturë relativisht e re, si qendër, por me një përgjegjësi të madhe shtetërore. Mund të na thoni diçka për histo-

rikun, misionin dhe përgjegjësitë e kësaj qendre?

Struktura përgjegjëse për kërkim-shpëtimitin në Republikën e Shqipërisë me emra të ndryshëm, herë si sektor e herë si qendër ka funksionuar që nga vitet 90. Në vitin 1991 Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Çikagos (Konventa Ndërkombëtare e Avioacionit Civil). Në vitin 1999 me VKM nr.3, datë 7.1.1999 "Për krijimin dhe funksionimin e shërbimit në fushën e kërkim-shpëtimit (SAR) të avionëve në rast aksidentesh ajrore", krijohet shërbimi i kërkim-shpëtimit. Në vitin 2002 krijohet Zyra e Kushtrim-Lajmërimit në përbërje të Qendrës së Bashkuar Operacionale si domosdoshmëri për bashkëpunimin, komunikimin dhe koordinimin efektiv me Qendrat Operacionale homologe. Në vitin 2003 Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën ndërkombëtare për kërkim-shpëtimitin në det". Në vitin 2004 lidhur me disa probleme të shqetësime që kishin lindur për mbulimin e koordinimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe sigurimin e komandim-kontrollit pa ndërmjetësim, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, u ngrit një grup pune për riorganizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR) në Forcat e Armatosura. Ky grup pune, pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha të dhënat e veprimtaritë e strukturave të kërkim-shpëtimit, propozoi që në Qendrën e Bashkuar Operacionale, të ngrihet Sektori (Qendra) e Koordinim-Shpëtimit (RCC), propozim i cili u miratua. Në vitin 2005 u bë zhvendosja e RCC nga Rinasi në ambientet e QBO-së. Në vitin 2007 krijohet Sektori i Kërkim-Shpëtimit në vartësi të Qendrës Operacionale të Mbrojtjes. Në vitin 2009 suprimohet Qendra Operacionale e Mbrojtjes dhe organizohet Qendra e Bashkuar Operacionale, në përbërje të së cilës krijohet Sektori i Koordinim-Shpëtimit. Në vitin 2011 miratohet Ligji nr 10345, datë 23.06.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë". Në vitin 2012, del VKM nr 372, datë 16.10.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës

Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit". Në vitin 2014, u bë riorganizimi i Qendrës së Bashkuar Operacionale dhe në vartësi të saj u krijua Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit. Në vitin 2016, me urdhër të Kryeministrit nr 158, datë 26.10.2016 "Për miratimin e Strukturës dhe Organizimit të QKKSH" dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr 1161, datë 24.11.2016 "Për organizimin e QKKSH", Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit del si strukturë më vete.

Aktualisht Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është organizuar dhe funksionon si strukturë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të Mbrojtjes.

Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, ku dallon ai nga emergjencat civile?

Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit(SAR) është një shërbim civil, por, në shumë raste, ai ngatërrohet me emergjencat civile. Baza ligjore ndërkombëtare e ka përcaktuar qartë misionin e shërbimit SAR, raportin e tij me sovranitetin kombëtar, si dhe hierarkinë e drejtimit dhe koordinimit gjatë operacioneve SAR. Shërbimi SAR është një shërbim pasiv dhe i organizuar që qëndron në gatishmëri 24/7. Në ndryshim nga emergjencat civile, aktivizohet kur gjatë aksidenteve ajrore dhe detare jeta e njerëzve është në rrezik real dhe kalon përsëri në sistem pasiv kur jetët njerëzore janë shpëtuar ose kur nuk ka më shpresë për të mbijetuar. Natyrisht, shpesh ndodh që gjatë emergjencave civile të aktivizohet sistemi dhe të kryhen operacione SAR.

Thatë që Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit është një detyrim ndërkombëtar, si ta kuptojmë këtë?

Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë është një shërbim i ngritur mbi bazën e konventave ndërkombëtare për kërkim-shpëtimitin (Konventa e Çikagos dhe ajo e Hamburgut) të cilat janë ratifikuar nga shteti shqiptar. Republika e Shqipërisë aderon në

këto konventa, ka zonën e saj të përgjegjësisë dhe ka mjaft detyrime ligjore. Në hapësirën territoriale kombëtare, tokësore dhe detare, shteti ka detyrimin ligjor të organizojë një shërbim SAR efektiv. Në këtë hapësirë, autoriteti i drejtimit të operacioneve SAR është i padelegueshëm ndaj një shteti tjetër, pasi shteti ka juridiksion të plotë jo vetëm në tokë, por edhe në detin e brendshëm dhe atë territorial. Po ashtu, në zonën e përgjegjësisë të SAR-it, jashtë hapësirës kombëtare, autoriteti i drejtimit operacional të shtetit është i padelegueshëm, në përputhje me marrëveshjet e arritura ndërkombëtare dhe si një detyrim ndërkombëtar. Operacionet SAR janë shumë komplekse, sensitive dhe që kërkojnë angazhimin e menjëhershëm të kapaciteteve kombëtare SAR, për të kërkuar, gjetur, shpëtuar dhe evakuuar persona në rrezik serioz për jetën, kudo dhe pa dallim statusi social, prandaj është e domosdoshme që të konsolidojmë më tej qendrën dhe shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të vijojmë realizimin me sukses të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe detyrimin kombëtar që ka Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-ve për këtë shërbim.

A ka Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit struktura vartëse operacionale për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit?

Jo. QKKSH nuk ka struktura operacionale në vartësi të saj për kërkim-shpëtimit. Janë Forcat e Armatosura, institucionet shtetërore si dhe subjektet private, që sa herë u kërkohet ndihmë nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, janë të detyruara të ofrojnë atë në njerëz dhe në mjete. Në bazë të ligjit nr. 10435, datë 23.06.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë" Ministria e Mbrojtjes (Forcat e Armatosura), Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin, ministria përgjegjëse

për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave kanë detyrim të mbështesin me kapacitetet e tyre operacionet e kërkim-shpëtimit. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është Koordinatori Kombëtar i Kërkimit dhe Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë dhe drejton operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit. Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë janë Koordinator Kombëtar Ajror i Kërkim-Shpëtimit (KKAKSH) dhe drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Ajrore të Kërkim-Shpëtimit. Roja Bregdetare është Koordinator Detar i Kërkimi-Shpëtimit (KKDKSH) dhe drejton operacionet nëpërmjet Qendrës



Kombëtare Detare të Kërkim-Shpëtimit. Strukturave të tjera të vendosura në vartësi operacionale sipas Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, afrojnë ndihmën e tyre në forca e në mjete.

Cilat janë prioritetet e punës së QKKSH për vitin 2021 e në vazhdim?

Një nga detyrat prioritare për vitin 2021 është ndjekja dhe zbatimi i detyrimeve të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, miratuar me VKM nr. 729, datë 13.11.2019, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e

Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij". Miratimi i Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit nga qeveria, ishte një arritje e rëndësishme në konsolidimin dhe mirë funksionimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, pasi në të përcaktohen saktësisht përgjegjësitë dhe detyrimet e strukturave shtetërore përgjegjëse për kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, për të vepruar në rastet e emergjencave SAR. Plani i veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit përmban 9 (nëntë) rubrika me rreth 70 (shtatëdhjetë) masa të shtrira për realizim në një periudhë kohore gjashtëvjeçare (2019-2025) si: Organizimi i shërbimit SAR, nënshkrimi dhe ratifikimi

i marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare SAR, rishikimi dhe hartimi i procedurave operacionale SAR, ngritja e infrastrukturës për shërbimin SAR, siguri i burimeve njerëzore SAR dhe trajnimi i tyre, modernizimi i pajisjeve SAR, stërvitja e strukturave SAR, monitorimi i zbatimit të planit kombëtar e raportimi si dhe detyra të tjera.

Zoti Kryetar, diçka më konkrete ku do të përqendrohet puna juaj gjatë vitit 2021?

E thashë edhe më lart detyrat janë të shumta por për këtë vit synojmë të hartojmë një manual kombëtar gjithëpërfshirës për

shërbimin e kërkim-shpëtimit, që është dhe një detyrim i Ministrisë së Mbrojtjes nga Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit. Ky manual do t'i përgjigjet situatës aktuale dhe nevojave në fushën e kërkim-shpëtimit. Për këtë qëllim kanë filluar procedurat për ngritjen e grupit të punës dhe grupit mbështetës për hartimin e Manualit të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe besoj se nga fundi i vitit do të kemi një manual SAR kombëtar. Hartimi i Manualit të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë do të jetë në përputhje me kërkesat e ICAO dhe IMO, duke marrë si model manualet IAMSAR. Grupi i punës do të bashkëpunojë dhe do të kërkojë asistencë nga specialistë të Mbrojtjes Civile, Mbrojtjes ndaj Zjarrit, Urgjencës Mjekësore, Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kufirit dhe Migracionit etj. Gjithashtu do të kërkohet asistencë nga specialistë të JRCC-ve të vendeve fqinje, specialistë të ICAO dhe IMO, për sigurimin e literaturës së nevojshme, dhe asistencë teknike. Trajnimi personelit/njësitë të institucioneve shtetërore të deklaruar për kërkim-shpëtimit (SAR) është një nga detyrat kryesore të Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit dhe njëkohësisht prioritet i QKKSH-së. Me qëllim rritjen e nivelit profesional të kapaciteteve të deklaruar për kërkim-shpëtimit, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ka ngritur një grup pune, për të bërë rishikimin dhe hartimin e programeve/moduleve të unifikuar të trajnimit dhe kualifikimit të personelit/njësitë të deklaruar për kërkim-shpëtimit (SAR). Edhe këto module do të jenë në përputhje me kërkesat e manualeve IAMSAR (ICAO/IMO), "International Aeronautical and Maritime Search and Rescue" dhe direktivave të dhëna për këtë qëllim Bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake dhe ministritë e linjës, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, me qëllim njohjen e përgjegjësive dhe të

detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR është një prioritet tjetër i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit për vitin 2021 e në vijim. Qendra kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ka patur dhe ka një bashkëpunim të ngushtë në fushën e kërkim-shpëtimit me Forcën Ajrore, Rojën Bregdetare/QNOD, Forcën Tokësore, Komandën Mbështetëse, Autoritetin e Aviacionit Civil, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Policinë e Shtetit, Policinë Kufitare dhe Emigracionit, pushtetin lokal, si dhe me Qendrat Rajonale të Koordinim-Shpëtimit (JRCC/ARCC/MRCC) të vendeve fqinje. Në zbatim të Planit të Koordinimit dhe Bashkëpunimit të QKKSH-së me strukturat e FA-së, institucionet shtetërore, pushtetin vendor dhe entet private për kërkim-shpëtimit të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, QKKSH ka zhvilluar disa aktivitete koordinimi dhe bashkëpunimi në fushën e kërkim-shpëtimit me Forcën Tokësore, Forcën Detare, Forcën Ajrore, QNOD, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Policinë Kufitare e të Migracionit në Durres, Albcontroll dhe Aeroportin e Rinasit. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, njohja e përgjegjësive dhe detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR.

Meqënëse po flasim për bashkëpunimin, si është ky bashkëpunim me strukturat homologe të vendeve fqinje dhe me organizatat ndërkombëtare të lundrimit ajror dhe detar?

Do të flisja dhe për këtë problem, pasi detyrimet tona janë në

kuadrin e sistemit global të kërkim-shpëtimit dhe kurrësi nuk mund të kryhen të izoluar. Mund të them sot për një bashkëpunim të shkëlqyer me Qendrën e Kontrollit të Misionit Satelitor në Bari, Itali (ITMCC) për marrjen, transmetimin dhe procedimin e sinjalit të "alarmit", duke realizuar me sukses të gjitha radio-komunikimet dhe shkëmbimet e informacionit me këtë qendër. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, duke u bazuar në aktet ligjore, konventat ndërkombëtare dhe kërkesat e manualit IAMSAR (International Aeronautical and Maritime Search and Rescue Manual) ka përgatitur draft-marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për kërkim-shpëtimit, draft i cili po ndjek procedurat e nënshkrimit dhe do jetë dhe si bazë edhe për marrëveshjet e tjera me vendet fqinje si Greqinë, Malin e Zi etj. Për theksuar është pjesëmarrja e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit në telekonferenca dhe webinarë të zhvilluara nga ICAO. Vetëm gjatë vitit 2020 ne morëm pjesë në 4 telekonferenca në Webex të zhvilluara nga ICAO EUR SAR/TF. Po ashtu ICAO, për shkak të situatës COVID-19, zhvilloi një seri Webinarësh 5 (pesë) për veprimtari të ndryshme kërkimi dhe shpëtimit në rajonin e Europës ku QKKSH ishte pjesëmarrëse aktive në to.

Duke përfunduar, cilat janë projektet tuaja për të ardhmen?

Personalisht do të punoj me të njëjtin përkushtim si deritani. Prioritet i punës time dhe i stafit që unë drejtoj, do të jetë forcimi i rolit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) si struktura kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

“Të lë gjurmën time në udhëtimin ushtarak”

Intervistë me tetar Irida Hyka, instruktore për “Rregulloren dhe Disiplinën” në kursin e parë Bachelor në AFA

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Pas tetë javësh stërvitjeje intensive në QAPU Bunavi, kadetët e programit Bachelor janë rikthyer në Akademinë e Forcave të Armatosura. Programi mësimor “Studime në Shkenca Ushtarake” është program studimesh universitar i ciklit të parë, i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në pesë kategori lëndësh, ku bëjnë pjesë lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Veprimtaritë formuese, që janë pjesë e programit “Bachelor” në shkenca ushtarake, ndahen në mësim në auditor; përgatitje individuale; veprimtari të tjera formuese të lidhura ngushtë me profesionin e ushtarakut, të tilla si: përnjohje terreni, analizë beteje, stërvitje fushore, vizitë mësimore, fushim dimëror e veror, praktikë në trupa, etj. Në programin bachelor vazhdojnë ndjekjen e programit 58 studentë. Tetar Irida Hyka, është Instruktore për Rregulloren dhe Disiplinën në ciklin e parë të studimeve Bachelor, në AFA, në vitin akademik 2020-2021.



Gazeta “Ushtria” e intervistoi tetar Irida Hykajn dhe sjell për lexuesit përvojën e saj.

Tetar Irida Hyka, ju keni filluar karrierën tuaj në FA në vitin 2011, si efektiv në kompaninë e ceremonialit, në batalionin e mbështetjes të SHPPFA-së. Si u bëtë pjesë e FA-së?

Cili është edukimi juaj bazë?

Kam lindur në Përmet, në shtator të vitit 1983 dhe shkollën e mesme të përgjithshme e kam kryer po atje. Më pas kam kryer studimet e larta në UBT, në Fakultetin Ekonomi dhe Agrobiznes, ku jam diplomuar në vitin 2009. Pasi u diplomova, dëshira ime

ishte të bëhesha pjesë e Forcave të Armatosura dhe pas informacioneve që mora në vitin 2010 kam konkuruar për UP, ku dhe u shpalla fituese. Gëzimi im ishte i madh, por dhe krenaria në grupin tim shoqëror dhe në jetën civile. Isha shumë kurioze të dija për jetën e re që më priste dhe për punën e re që do të filloja. Në 1 maj të vitit 2011, kam veshur për herë të parë Uniformën e FA-së. Emocion i papërshkruar, që nuk e kisha ndjerë më parë! Tashmë isha dhe unë një ushtarake. E thënë ndryshe plotësova dëshirën e madhe për t'u bërë pjesë e uniformës ushtarake.

Çfarë trajnimesh ushtarake të mëtejshme keni kryer? Cilat janë hapat që ju keni hedhur, derisa në tetor 2020 u bëtë pjesë e stafit të formimit ushtarak, në Akademinë e Forcave të Armatosura, në fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë?

Pasi u përfshiva në radhët e FA-së, në vitin 2011-2012 përfundova në Shkollën e Trupës Bunavi, të dy kurset SIA dhe SIB me rezultate të larta. Detyra ime e radhës pas titullimit UPII ishte në kompaninë e Ruajtjes së BMSHP, përgjegjës skaner në Ministrinë e Mbrojtjes, ku kjo detyrë e rëndësishme ka vazhduar deri në fund të vitit 2014. Unë vazhdova me formimin tim të mëtejshëm profesional, me mundësitë që të ofrojnë Forcat e Armatosura kur bëhesh pjesë e tyre. Në fillim të vitit 2015 përfundova kursin institucional fillestar të Nënoficerit në Akademinë e Nënoficerave Thomson. Në atë kurs përgatiteshim për komandant grupi. Po në vitin 2015 bëra kërkesë për t'u bërë pjesë e ANO-së. Këtë herë jo si kursant po si Instruktor. Kërkesa ime u miratua duke marrë parasysh edhe rezultatet e nxjerra në vijim dhe në përfundim të kursit.

Në formimin tim si Instruktor kanë ndikuar edhe eprorët apo kolegët të cilët duke marrë parasysh edhe dëshirën për të mësuar si vetë ashtu dhe të tjerët nuk e kanë reshtur kurrë ndihmën e tyre duke më mësuar dhe mbështetur në hapat që merrja në të mirë të programit mësimor dhe stërvitor.

Gjatë vitit 2017-2018 kam qënë

në AFA, me detyrë administrator pranë zyrës së komandantit dhe në shtator të vitit 2017 kam kryer kursin bazë të Nënoficerit pjesa e parë Leadership, ndërsa në prill të 2018 kam kryer pjesën e dytë të kursit bazë, specialiteti këmbësori në Qendrën Stërvitore FT. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura do të thotë të jesh gjatë gjithë kohës në trajnim dhe stërvitje, të përvetësosh artin ushtarak dhe të ecësh nën gjurmët e më të mirëve, për të lënë edhe ti gjurmën tënde në këtë udhëtim të bukur dhe të vështirë. Të arsimohesh dhe stërvitesh është parësore, vlerësimi i eprorëve dhe pedagogëve të tu është gjithashtu, jo vetëm një tregues dhe stimul për ty, por edhe një shpërblim i djersës dhe sakrificës. Një ndër notat që më 'prishte' të gjithë biografinë e notave të tjera ishte 9-ta në përgatitje zjarri, ndërsa të pesë vlerësimet e tjera i kisha me notën 10. U rendita e para në kursin bazë të Nënoficerit.



erit. Pas mbarimit të kursit bazë, u emërova përsëri në ANO, Instruktor në kursin Bazë të N/of.

Në vitin 2018, në procesin e përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë të vitit 2018, bazuar mbi një sërë rubrikash, ku morën pjesë 72 nënoficerë, në përfundim sipas listë-meritës, ju u përzgjedhën nënoficer i vitit. Si u ndjetë?

Pothuajse në të gjitha aktivitetet që ka kryer FA, në kuadër të 28-29 Nëntorit, 5 garshin, Nënoficer i vitit etj., kam marrë gjithmon pjesë,

dhe sa herë që kam marrë pjesë në këto aktivitete unë kam zënë edhe vendet e para. Procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2018 u realizua në një sërë rubrikash. Pjesë e kriterëve përzgjedhëse ishin edhe vlerësimet vjetore të performancës së nënoficerëve. Pra përzgjedhja e Nënoficerit të vitit konsistonte me testimin e disa disiplinave, si testimi intelektual, testimi i gjuhës së huaj anglisht, marshim me ngarkesë 15-20 kg, 24 km, testim i përgatitjes fizike me të treja disiplinat, dhe prezantimi i një teme "Briefing".

Do testoheshim 3 herë brenda një harku kohor 30 ditor. Një testim e bënte reparti, një testim tjetër me tre vendet e para e bënte forca dhe testimin e fundit e bënte Bordi, në rang të Forcave të Armatosura. Në këtë proces morën pjesë 72 nënoficerë nga grada e nëntetarit deri tek grada rreshter. Në përfundim sipas listë-meritës unë u

përzgjedha si nënoficer i vitit. Risi nga vitet e kaluara, siç u shpreh dhe Bordi i Përzgjedhjes, ishte se në në procesin e këtij viti ishin përfshirja si kriter përzgjedhës edhe e elementit të marshimit në distancën që për-menda më lart, por edhe rritja e numrit të femrave në konkurim, në një masë prej 20%.

Por edhe një vit më vonë në procesin e përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2019, duke ju referuar testimet dhe rezultateve përfundimtare sipas listë-meritës, bordi qendror i ngritur për këtë

qëllim ju shpalli përsëri nënoficerin e vitit 2019. Çfarë do të thotë për ju ky vlerësim i dytë?

Po. Në vitin 2019, unë përjetova një tjetër emocion që ishte edhe më i madh se ai i një viti më parë. Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2019. Në këtë proces konkurimi morën pjesë të gjithë nënoficerët me gradën N/tetar-Rreshter të të gjithë insitucioneve të vartësisë së KDS, AFA, ANO, SHT Bunavi, QS e QDK. Procesi i konkurimit përfshiu disa disiplina, si testimi intelektual, ai fizik, e gjuha e huaj. Duke ju referuar testimeve dhe rezultateve përfundimtare sipas listë-meritës, bordi qendror i ngritur për këtë qëllim më shpalli përsëri nënoficerin e vitit 2019. Isha efektiv i ANO-së në atë kohë.

Aktualisht ju jeni instruktore e Rregullores dhe Disiplinës në ciklin e parë të studenteve Bachelor, në vitin akademik 2020-2021, në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ku konsiston puna juaj me kadetët?

Kam kryer detyrën e komanduar si Instruktore, në Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri, më parë. Ky urdhër më erdhi papritur dhe ishte përzgjedhja e lidershit të FA-së. E kam përjetuar me shumë emocion si dhe jam ndjerë shumë e vlerësuar atëherë. Jo vetëm për detyrën që m'u besua por dhe nga vetë stafi që merej me trajnimin e KPOR. Por ndërkohë kjo detyrë

më bëri jo vetëm të "ndjehesha borxhlie" ndaj atyre njerëzve që më vlerësuan, por njëkohësisht dhe një detyrim moral për të dhënë më të mirën me korrektësinë, përkushtimin dhe seriozitetin që karakterizon një efektiv të FA-së. Pak kohë më vonë në mars të 2020 u bëra pjesë e Forcave Tokësore, në Bataljonin e Dytë të Këmbëorisë, me detyrë komandante skuadre tg3sk3. Ishte kërkesa ime si pasojë e dëshirës që kisha për ta përsosur akoma dhe më shumë specialitetin tim si këmbësor. Në atë batalion aq të rëndësishëm, jo vetëm për Forcat Tokësore, pata fatin të punoj me ushtarakë, vartës apo eprorë të cilët ishin të pa lodhur dhe tepër bashkëpunues, ku përveç angazhimit të madh stërvitor të përditshëm në fund të ditës merrje jo vetëm kënaqësinë për realizimin ditor të objektivave, por edhe vlerësimin e merituar. Pas këtij rrugëtimi në struktura të FA-së, në tetor të vitit 2020 më komunikuan urdhrin për emërim në Akademinë e Forcave të Armatosura. Nuk e prisja një vlerësim kaq të lartë, ashtu sikurse nuk e prisja të isha pjesë e këtij kursi që u hap për herë të parë. Puna ime konsiston në rregullin, disiplinën por edhe mesimdhënien në Rregulloret bazë ushtarake edhe Rregulloren rrjesh-tore. Ndërkohë unë kam mbaruar pjesën e parë të kursit të avancuar në ANO, LiderShip.

Cilat janë kushtet dhe kërkesat në respektim të masave anti-covid, të dala nga strukturat ushtarake, që ju zbatoni në përditshmërinë tuaj? E bën të

vështirë kjo punën tuaj?

Në zbatim të protokolleve që dalin nga Ministria e Shëndetësisë, ne aktualisht si forcë e armatosur zbatojmë "protokollin e masave sh-trënguese" të nxjerrë nga ministri i Mbrojtjes dhe urdhrin e SHSHP-së, "për parandalimin e përhapjes së COVID-19".

Patjetër që kushtet në cilat ndodhemi kërkojnë më tepër përkushtim dhe kontrollë rigoroze, në mbajtjen e maskave, respektimin e distancave, ajrosjen dhe dezinfektimin e ambjenteve ku zhvillohet procesi mësimor/stërvitor. Absolutisht kërkon më shumë impenjim por ja kemi dalë me sukses deri tani.

Kush janë synimet tua të mëtejshme të karrierës ushtarake?

Unë do të vazhdoj të shërbej me përkushtim dhe pasion në forcat e armatosura, me objektivin për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të avancuar në karrierë. Përtej objektivave të mia personale, unë dua që të përfaqësoj edhe modelin më të mirë të gruas nën uniformë, duke dhënë shembullin se edhe ne gratë mundemi! Shpresoj të bëj më të mirën me singëritet dhe pasion. Në përfundim dua të falenderoj të gjithë kolegët, vartësit dhe eprorët me të cilët kam punuar gjithë këto kohë, i falënderoj nga zemra për bashkëpunimin, ndihmën dhe mbështjen, dhe ju premtoj që nuk do t'i zhgënjej në këtë rrugëtim sa të bukur aq dhe të vështirë.



Marsi, muaji i figurës ushtarake femërore

Përgjegjësi operacionale, kombëtare dhe përfaqësim dinjitoz

Në ditët e para të marsit, kontigjentit shqiptar në misionin e KFOR-it në Kosovë, iu bashkuan edhe 5 gra dhe vajza nga Forcat e Armatosura shqiptare, ku 1 është civile

Misioni i KFOR-it në Kosovë i udhëhequr nga NATO, një rolet jetike që gratë luajnë në paqe dhe siguri dhe rëndësinë e inkorporimit të perspektivave gjinore në operacionet e KFOR-it. Afrimi i KFOR-it është i kornizuar rreth parimeve të integritetit, gjithëpërfshirjes dhe integritetit. Zyra e Këshilltarëve Gjinor të KFOR-it, e përbërë nga femra dhe meshkuj, siguron që KFOR-i të marrë parasysh nevojat e ndryshme të sigurisë së burrave, grave, djemve dhe vajzave në Kosovë. Forcat e Armatosura shqiptare janë aktualisht të angazhuara në këtë mision paqeruajtës krahas misioneve të tjera të NATO-s.

Pikërisht në ditët e para të marsit kontigjentit shqiptar, në misionin e KFOR-it në Kosovë, iu bashkuan edhe 5 gra dhe vajza nga Forcat e Armatosura shqiptare (4 ushtarake dhe 1 civile), për të kontribuar për një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur të Kosovës, në koordinimin e përpjekjeve ndërkombëtare humanitare, për mbështetjen dhe

zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme, demokratike, multietnike dhe paqësore, si dhe mbështetjen e zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Nënkonele Alda SULA
Shtabi i Përgjithshëm i FA-së,
Shefe Shtabi e Grupimit të
Përbashkët të Mbështetjes
Logjistike të KFOR-it dhe
Perfaqësuese e Lartë Kombëtare
Misioni i dytë



"Tashmë jo më një rrugë e pashkelur, jo më një mjedis i panjohur. Të njëjtat përgjegjësi e angazhime, por edhe kjo herë kishte sfidat e veta. Realizimi i detyrave në kushtet e pamdemisë dhe me zgjidhje alternative", na thotë nënkonele Alda SULA, që vjen nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, me detyrë në mision, Shef Shtabi i Grupimit të Përbashkët të Mbështetjes Logjistike të KFOR-it dhe Perfaqësues i Lartë Kombëtar.

Nënkolonele Alda Sula është në këtë mision për herë të dytë. "Zbatimi i procedurave standarte të veprimit, ndjekja e një protokollit rigoroz me masat anti-Covid të

KFOR-it, si dhe sinkronizimi i tyre me politikat kombëtare, ishin shqetësimi kryesor. Krahas përgjegjësiwe individuale, si përfaqësues e Lartë kombëtare, mbizotëronte dhe përgjegjësia kolektive". Alda thotë që gjeti një personel shumë të përgjegjshëm dhe koshient për detyrat e ndërmara, duke e parë veten në pozicion të favorshëm për të gjetur të gjithë mirëkuptimin e mundshëm, jo vetëm për të realizuar detyrën parësore nën autoritetin operacional të komandantit të KFOR-it, por dhe në drejtim të mbështetjes morale, psikologjike e sociale të kontigjentit shqiptar.

Një element tjetër që Alda veçon është dhe fakti i rritjes së numrit të femrave në mision. Aktualisht, janë 5 ushtarake gra dhe vajza. Përveç Aldës, të gjitha janë në mision për herë të parë. Detyrimi për mbështetje, këshillim e komunikim rritet. Është si një familje ku më i madhi ka përgjegjësinë e kujdesit ndaj më të vegjëlve, siç shprehet nënkolonele Sula. Rritja e prezencës së ushtarakeve femra është aq inkurajues sa edhe ana psikologjike e morale për mbarëvajtjen e misionit. Kjo falë interesimit dhe politikave "gender" që ndjek lidhshipi ushtarak e civil i MM-së dhe SHP-së edhe për misionet.

Slogani/motoja tepër kuptimplotë e komandantit të KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici "AS ONE WE PROGRESS" sinkronizon efektshëm dy detyrat, përgjegjësitë operacionale dhe ato kombëtare, për një përfaqësim dinjitoz dhe realizim të suksesshëm të misionit.

**Majore Adelaida Shehu
Komanda Mbështetëse,
Officere për sigurinë në
grupin mbështetës të KFOR-it
Misioni i parë**

"E mora me entuziazëm faktin e pjesëmarrjes time në një mision paqeruajtës. Një eksperiencë e re,

sfidë, dhe në pritshmëritë e mia, e parë si një shans pozitiv për ecuri në karrierë. Detyra që mbuloj është një detyrë që është kryer kryesisht nga meshkuj, duke bërë që në fillim ndoshta të ndihesh paksë e pasigurt, duke menduar vështirësitë me të cilat do të përballesh. Detyra kryesore e imja është të kryej detyra, si officer i sigurisë së kampit, duke planifikuar dhe koordinuar të gjitha masat e sigurisë me karakter mbrojtës për shtabin e KFOR-it. Por them se duhet vetëm predispozicion, seriozitet e përkushtim, që çdo gjë të ecë në rrugën e duhur. Janë këto cilësi që më ndihmuan që të ingranohesha shumë shpejt me detyrën dhe ambjentin përreth. Besoj se deri në fund të misionit kam për t'ia dalë me sukses, duke justifikuar përzgjedhjen time në këtë nision", thotë majore Adelaida Shehu.

**Kapitene Elisabeta Alcani
Akademia e Forcave
të Armatosura,
Officer koordinativ për BCU,
në Qendrën e Efekteve
të KFOR-it
Misioni i parë**

"Ndjehem e privilegjuar që marr pjesë në një mision të tillë, siç është misioni i KFOR-it në Kosovë. Mendoj se çdo ushtarak duhet të ketë të përfshirë në CV e tij pjesëmarrjen në një mision, pasi e shoh shumë kuptimplotë. Kisha dëgjuar nga kolegët e mi, që kanë shërbyer në këtë mision, dhe faktin e daljes së urdhërit për të ardhur në KFOR e mora me shumë ngazëllim, por pa e fshehur edhe me njëfarë ndroje. E quajta sfidë realizimin e një detyre paksë të ndryshme nga ajo që bëj në AFA, një sfidë, faktin e një jetese për 6 muaj në një mjedis shumëkombësh. Por vetë natyra e detyrës që unë mbuloj, Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak, m'i ka lehtësuar disi përpjekjet e mia. Veproji si oficere e parë koordinuese për çështjet e in-

frastrukturës civile me organizatat joqeveritare, lokale e shtetërore, kompanitë publike më kryesore si energjia, ujësjells, etj., në mbarë Kosovën. Unë jam një nënë e re dhe duke patur një fëmijë në moshë të vogël 3 vjeçare, them se shkëputja nga familja për në periudhë 6 muajore, është një sakrificë që ne e ndërrmarim, por që nga ana tjetër na bën më të përgjegjshme për tu angazhuar maksimalisht për përm-bushjen e detyrës me dinjitet, për vet figurën e femrës, të FARSH e të vendit", u shpreh për shtypin ushtarak të FA-së shqiptare kapitene Elisabeta Alcani.

**Kapitene Anita Gruda
Agjencia e Sistemeve
të Ndërlidhjes,
Officere për Forcën
Tokësore në QBO, në KFOR
Misioni i parë**

"Përzgjedhjen time në këtë mision personalisht e mora si sfidë më vete. Në natyrën time gjithmonë kam patur parimin "female lead from the front", që nënkupton që këtë detyrë, përveç faktit të përzgjedhjes së një figure femërore, nga ana tjetër është një tregues se ne mundemi të bëjmë gjithçka, të marrim përsipër të mbulojmë edhe ato pozicione që në të shumtën e rasteve mbulohen nga meshkujt.

Fakti që unë mbuloj një pozicion që për më tepër është pozicion shërbimi sesa zyre, përsëri nuk më ka trembur. Koordinoj menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me operacionet e forcës tokësore brënda QBO-së. Por duke e marrë me sportivitet, them se deri më tani ja kam dalë të ingranohem me lehtësi, si me punën ashtu dhe me mjedisin përreth e bashkëpunimin me shumë kolegë të vendeve të ndryshme, duke më bërë që ta ndiej veten të pranueshme e të respektueshme në këtë mjedis."



MAJORE ADELAIDA SHEHU



KAPITENE ELISABETA ALCANI



KAPITENE ANITA GRUDA

Hapen dokumentet arkivore për Luftën e Dytë Botërore dhe Luftën e Ftohtë

Dokumentet janë në dispozicion të studiuesve dhe publikut të gjerë, sidomos për studentët e masterit dhe doktoraturës

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-albania nëpërmjet dy sistemeve SQDNE (sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS (sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari).

Arkivat janë memorie në jetën e kombeve, janë një vlerë e përjetshme e identitetit të një populli. Janë një shtëpi e madhe me raftë të mbushura me dokumentacione, që rrugëtojnë nëpër histori, janë fakt që asgjë dhe askush nuk mund t'i fshehë, apo ndryshojë. Arkivi është shtëpia e së vërtetës...

AQFA është institucioni qendror i sistemit të Mbrojtjes, që përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e fondit arkivor kombëtar, që krijohet gjatë veprimtarisë së strukturave të MM. Arkivi pasurohet me materiale kombëtare ushtarake vit pas viti, materiale të cilat pasqyrojnë historinë tonë ushtarake. Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë, si nga ana kulturore, historike dhe shkencore, arkivat ruhen në mënyrë të përhershme. Misioni i Arkivit është të përthithë dokumentacionin e Forcave të Arma-



tosura.

Le të njihemi shkurtimisht me rrugëtimin e këtij institucioni ndër vite...

Arkivi ka filluar rrugëtimin e tij që me themelimin e shtetit shqiptar në 1912, si një zyrë sekretarie që funksiononte pranë Shtabit Madhor. Në Nëntor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë do të bëhej streha e parë e dokumenteve zyrtare të shtetit shqiptar. Dokumentet e qeverisë, ministrive, bashkive, kuesturave, të ushtrive kuislinge, u bënë baza e Fondit Arkivor Kombëtar. Në vitin

1950 në Ministrinë e Mbrojtjes pranë Degës së Studimeve dhe Botimeve u ngrit kartoteka e historisë dhe do të funksiononte si e tillë deri në vitin 1960 si baza e themelimit të mëvonshëm e Arkivit të Ushtrisë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 21 Mars 1964 e legalizoi atë zyrtarisht si institucion, "Arkivi i Ushtrisë" sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, që këtë vit përkon me 57-vjetorin e krijimit zyrtar.

Për të parë sesi funksionon AQFA dhe për t'u njohur me shumëllojshmërinë e dokumentacionit që

disponon dhe projektet e realizuara e ato në proces realizimi, vizituam ambientet e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ku zhvilluam një intervistë me drejtorin Prof.asoc. dr Teki Kurti.

Z. Kurti është në krye të këtij institucioni prej vitit 2014. Ai e konsideron veten me fat të jetë drejtori i një institucioni me një rëndësi të tillë për Forcat e Armatosura.

Një nga proceset më të rëndësishme është mirëmbajtja e dokumentacionit që AQFA disponon, si realizohet mbrojtja e materialeve dhe si është situata në vendruajtjen e tyre?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Më përpara dokumentacionet kanë qenë të shpërndara në reparte, por tashmë ato ruhen në gjendje të mirë në godinën e vetë institucionit. Një pjesë e mirë e ambienteve të godinës është

ministron larmishmëri dokumentesh të një periudhe kohore rreth 90 vjeçare (1922-2013) të tilla si: Dokumente historike; Dokumente të LANÇ-it; Dokumente politike (v. 1945-1990); Dokumente të klasifikuar "sekret shtetëror"; Dokumente teknike; Dokumente të arsimit ushtarak; Dokumente në figurë dhe në zë; Shtypin ushtarak; Botime dhe përmbledhje legjislativ; Dosje personale etj. Ajo çka është më e rëndësishme është se në varësi të institucioneve fondkrijuese dhe llojit të dokumenteve, janë krijuar dhe administrohen 535 fonde arkivore me një volum prej afërsisht 4300 metër linear, ose e shprehur ndryshe rreth 40 milion fletë, 6400 kuti, 321.698 dosje fashikuj, 3105 bobina për dokumentet e mikrofilmuara, 1398 rregullore, manuale, shtypi dhe botimet ushtarake. E gjitha kjo që ne disponojmë është një thesar, pasi pa arkiva ska histori dhe pa

të strukturave të suprimuara, që administrojnë komandat e forcave, rreth 40 ish reparte të suprimuara (fonde të papërpunuara). Një arritje tjetër në zbatim të akteve ligjore, me po kaq rëndësi, është marrja nga DPA e fondit të Këshillit të Mbrojtjes. Në zbatim të VKM nr. 487 datë 17.10.1994 dhe urdhrin të Ministrit të Mbrojtjes nr. 714, datë 04.12.1995, pas 26 vitesh, u mor në administrim nga Fondet e Arkivit të Komitetit Qendror, të depozituar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, fondi arkivor i Këshillit të Mbrojtjes për vitet 1963-1991. Përgatitja e ekspozitave ka pasur si qëllim njohjen e publikut me përmbajtjen e dokumenteve edhe nxitjen e frekuentimit të arkivit, ku publiku t'a perceptojë pasurinë dokumentare si pasuri të vetën. Mbajtja e ekspozitës për 55 vjetorin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura është një nga organizimet më mbreslënëse.



AQFA shpesh është konsideruar si një institucion hermetik, por me shërbimin online komunikimi me institucionin është lehtësuar në mënyrë të konsiderueshme. Si realizohet procesi i shërbimit online?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Një arritje e AQFA-së, dhe mbase më e madhja, është shërbimi ONLINE. Arkivi ynë si pjesë e kujtesës së kombit është në sprovën e hapjes dhe shërbimit të informacionit ndaj qytetarëve, institucioneve dhe studiuesve. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153 datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online, nga data 1.1.2020", Arkivi Qendror i FA-së, ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-albania nëpërmjet dy sistemeve SQDNE (sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS (sistem shkëmbimi kërkesë/përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari). Çdo qytetar apo institucion mund t'i drejtohet për informacion elektronikisht AQFA-së, në lidhje me 17 shërbimet e listuara në sistem dhe të marrë përgjigje brenda afatëve kohore të përcaktuara në ligj. Me

vënë në dispozicion të tyre. Temperatura dhe lagështia janë faktorët kryesor për ruajtjen e dokumentacionit, pra ambienti duhet të ketë kondicionim dhe siguri mbrojtje nga dielli, në mënyrë që materialet të mos dëmtohen.

Në AQFA gjenden me qindra materiale, cilat janë disa prej tyre, të cilat AQFA administron dhe i ruan me fanatizëm?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA ad-

histori ska komb.

Arkivi ndër vite ka realizuar projekte dhe ekspozita, cilat janë më të rëndësishmet në 2 vitet e fundit?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA ndër vite ka realizuar një serë projektesh, por një prej tyre që vlen të përmendet është dorëzimi i dokumenteve të njësisë e reparteve të suprimuara. AQFA gjatë vitit 2020 mori në dorëzim të gjitha fondet arkivore

VKM është përcaktuar afati 48 orë për kthimin përgjigjeve midis institucioneve, ndërsa midis qytetarëve 15 ditë pune, sipas ligjit nr. 119 "Për të drejtën e informimit". Dokumentet vulosen elektronikisht dhe dërgohen në adresat përkatëse duke respektuar afatet e kthimit të përgjigjeve. Kjo praktikë ndihmon qytetarin të kryej një kërkesë online në kushte komode (p.sh nga celulari i tij) dhe të marrë një përgjigje po ashtu komode dhe pa u sorollatur nëpër institucione. Gjithashtu, eliminohen radhët e gjata, pritjet e padëshirura. Një element, që mund t'a quajmë "negative", nga praktika online, është mungesa e komunikimit ballë për ballë, ku jepen specifika dhe elemente më të detajuara në lidhje me plotësimin e kërkesës. Sektori i Informacionit punon aktualisht në bashkëpunim me sektorët e tjerë, për të arritur objektivat dhe për të qenë sa më korrekt në kthimin e përgjigjeve brenda afateve kohore, ku periodikisht plotësojmë regjistrin e transparencës për kthim-përgjigjet dhe hidhet tek faqja zyrtare e Ministrisë së Mbrojtjes. Pra, ajo çka dua të them është se, sot duke pasur shërbimin online kërkesat realizohen shumë më shpejt dhe të gjithë të interesuarit qofshin studiues të brendshëm, apo të jashtëm pajisen me informacionin e nevojshëm në kohë.

Çfarë mund të na thoni për deklasifikimin e dokumenteve të arkivit të ushtrisë?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Në zbatim të legjisllacionit për informacionin e klasifikuar dhe në respekt të parimit; "Një qytetar i mirinformuar është një qytetar i lirë", në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Zbulimit në SHPPFA dhe Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, kemi nisur deklasifikimin masiv të dokumenteve. Ka përfunduar deklasifikimi i dokumenteve të personelit organizimit, të arsimit ushtarak, të degëve ushtarake të 28 rretheve, të hartografisë ushtarake, si dhe ato politike që përmbajnë informacion të klasifikuar: Fondi i Komitetit Qendror të PPSH-së, Drejtoria Politike, dokumente të informacionit të klasifikuar për vitet 1946-1974.(2172

dosje); Informacioni i klasifikuar prodhuar nga komitetet e partisë në ushtri, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, komandat, njësitë, repartet dhe institucionet në varësi të tyre, për titullim, gradim, emërim, transferim, lëvizje, vënie në dispozicion, dalje në rezervë, dalje në lirim, dalje në pension, dalje në asistencë të kuadrit oficerë, nënoficerë, rezervistë dhe punonjës civilë; Dokumente nga fondet e Sek-

janë përzgjedhur dhe përfshirë në këtë botim.

Si trajnohet personeli për të miradministruar dokumentacionin?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Me një rëndësi të veçantë është vlerësuar trajnimi i personelit për metodologjinë e punës me dokumentet, të cilën e kemi realizuar në bashkëpunim me



retariatit, (Sektori i Përgjithshëm), Shtabi i Përgjithshëm, Drejtorisë Operative dhe Stërvitjes, Drejtorisë së Organizimit Mobilizimit. Jemi në proces për hartimin e bibliografisë për deklasifikim në vijimësi të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Tashmë nën drejtimin tuaj, AQFA boton rregullisht "Buletin Arkivor Ushtarak",sa i rëndësishëm është ky botim dhe cilin prej Buletinëve do të veçonit?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: AQFA periodikisht boton Buletin Arkivor Ushtarak me përmbledhje dokumentesh arkivore të pa publikuara më parë. Do të veçoja botimin fundit të Buletinit Arkivor Ushtarak, i vitit 2020, me temë "Përmbledhje dokumentesh arkivore të Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Ftohtë", i cili vjen në dispozicion të studiuesve dhe publikut të gjerë, me dokumente që botohen për herë të parë. Këto dokumente tashmë janë të hapura, në dispozicion të studiuesve si dhe studenteve të masterit e doktoraturës. Veçanërisht disa prej tyre,

Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Strukturat e Forcave të Armatosura. Për të siguruar miradministrimin e dokumenteve në strukturat e FA-së, si institucione bazë fondkrijuese, puna e drejtuesve dhe e specialistëve me eksperiencë të AQFA-së ka vijuar nga trajnimet e përvitshme në dhënie ndihmë metodologjike e profesionale për punën me dokumentet në 43 sekretari-arkiva.

Projekti për digjitalizimin e arkivës ushtarake është shumë i vlefshëm, pasi do t'i sjellë më afër qytetarët, studiuesin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Si po ndiqet ky proces?

Prof.asoc.dr Teki Kurti: Prioritet kryesor në rrugën tonë mbetet modernizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ruajtjes dhe shërbimit të dokumenteve si për qytetarët, institucionet, studiuesit e brendshëm dhe ata të huaj. Për këtë në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Automatizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, u arrit miratimi i projektit për "Sistemimin e digjitalizimit të fondeve arkivore" ku pritjet vetëm financimi i tij për zbatim.

Ditën e dielë, më 28 mars 2021, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, me anë të një mesazhi ka uruar personelin ushtarak aktiv dhe civil si dhe ushtarake në rezervë, në 76-vjetorin e krijimit të Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej", si më poshtë vijon: "Të nderuar ushtarake aktive, në rezervë dhe civile të Forcave të Armatosura! Dita e sotme e këtij 28 Marsi, shënon 76-vjetorin e krijimit të Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej". Kjo shkollë, për rreth një gjysmë shekulli, përgatiti dhe formoi themelet e pothuajse të gjithë trupës së oficerëve të Forcave të Armatosura.

Niveli dhe cilësia, programi dhe disiplina, kultura dhe qytetaria, e klasifikuan Shkollën "Skënderbej" si ndër më të mirat dhe më të njohurat në historinë e arsimit të mesëm shqiptar, duke e bërë atë simbol të krenarisë, nderit dhe pjesë të lavdisë së historisë sonë ushtarake. Nga auditorët e kësaj shkolle kanë dalë komandantë, drejtues, lider dhe menaxherë të çdo niveli të Forcave të Armatosura, por edhe shumë personalitete e autoritete që kontribuan dhe kontribuojnë në shkencë, politikë, ekonomi, mjekësi, diplomaci, kulturë, art, sport, biznes, etj. Në këtë përvjetor, një mesazh i veçantë

Mesazh për 76-vjetorin e Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej"

Shkolla e Mesme Ushtarake "Skënderbej", për rreth një gjysmë shekulli, përgatiti dhe formoi themelet e pothuajse të gjithë trupës së oficerëve të FA



respekti, nderimi dhe mirënjohjeje shkon për të gjithë drejtuesit, edukatorët dhe punonjësit e tjerë civilë e ushtarakë të kësaj shkolle, që me punën dhe përkushtimin, pasionin dhe dashurinë e treguar, e kthyen atë në një monument lapidar në kujtesën e shumë brezave që kanë kaluar pragun e asaj shkolle. Në këto ditë të vështira të pandemisë

së pazakontë, mundësia e vetme e nderimit dhe respektimit të emrit dhe veprës lavdimadhe të këtij tempulli të shenjtë të dijes dhe edukimit, të Shkollës "Skënderbej", në këtë 76 - Vjetor, ngelet shprehja e urimeve më të mira për të gjithë nxënësit, drejtuesit, mësuesit dhe punonjësit e saj ndër vite, kudo që janë brenda dhe jashtë Shqipërisë".

Presidenti i Republikës, Ilir Meta

Me rastin e 76-vjetorit të krijimit të Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej", Presidenti i Republikës, Ilir Meta çmoi Shoqatën Kombëtare "Skënderbegasi" me Dekoratin e lartë "Nderi i Kombit", me motivacionin: "Në shenjë vlerësimi për merita dhe punën e veçantë në ruajtjen dhe zhvillimin e traditave të Shkollës së Mesme Ushtarake 'Skënderbej'. Për kontributin e çmuar në fushën kërkimore shkencore nëpërmjet studimeve e botimeve të shumta profesionale". Në fjalën përshëndetëse, drejtuar anëtarëve të Shoqatës "Skënderbegasi" dhe personaliteteve të pranishme në ceremoninë solemne të organizuar

"Nderi i Kombit" për Shoqatën Kombëtare "Skënderbegasi"

me këtë rast, Kreu i Shtetit u shpreh: "Është një emocion i veçantë për mua të organizoj këtë ceremoni vlerësimi, edhe si djali i mësuesit të Shkollës së Mesme Ushtarake 'Skënderbej', i rritur pjesërisht në ambientet e kësaj shkolle të madhe, që ka lënë gjurmë të forta në historinë e shtetit tonë, falë kontributit të jashtëzakonshëm të dhënë nga breza të tërë mësuesish dhe pedagogësh, sidomos të atyre mijërave "skënderbe-

gasve", që u rritën, u edukuan dhe u bënë jo vetëm mbrojtës besnik të Atdheut, duke shkëlqyer në të gjitha fushat e sigurisë, por që spikatën edhe në fusha të tjera, duke qenë krenar se ishin 'Begsa'. 28 marsi i vitit 1945 është një datë e veçantë dhe historike, pasi pikërisht pak muaj pas çlirimit të Atdheut 300 partizanë të vegjël zbritën nga malet dhe u ulën në bankat e kësaj shkolle të sapoformuar; fillimisht të cilësuar si 'Shkolla e Pionierëve të Luftës' dhe më pas si Shkolla Ushtarake 'Skënderbej'.

Ndërron jetë gjeneral brigade Ndriçim Sallaku

Presidenti Ilir Meta i akordon Dekoraten "Nderi i Kombit" gjeneral brigade Ndriçim Sallakut

Më datë 20 mars 2021, është ndarë nga jeta, nga sëmundja e rëndë e shkakuar nga COVID-19, me gjithë kujdesin shëndetësor, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Forcat e Armatosura kanë humbur me gjeneral brigade Sallakun, ushtarakun kurajoz, liderin e spikatur, profesionistin e shkëlqyer dhe njeriun e përkushtuar, ndërsa familja babain, bashkëshortin, gjyshin, familjarin e shtrenjtë. Lutemi për forcë për të përballuar këtë situatë të vështirë në jetën e tyre.

Gjeneral Brigade Ndriçim Sallaku lindi më 14 qershor 1966 në Durrës. Gjeneral brigade Sallaku filloi karrierën ushtarake në vitin 1987, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe ka shërbyer me devotshmëri për 34 vjet në Forcat e Armatosura, kryesisht në degën e Logjistikës në të gjitha nivelet e komandimit. Karriera e tij në Forcat e Armatosura kulmoi me marrjen e gradës gjeneral brigade në vitin 2019, me dekret të presidentit të Republikës nr. 11077, dhe prej asaj date vijonte të kryente detyrën e komandantit të Komandës Mbështetëse.

Gjeneral brigade Sallaku ka shërbyer në një numër misionesh ndërkombëtare dhe është vlerësuar me medalje nga OKB dhe BE, për kontributin e tij në Misionin Paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Gjeorgji (UNOMIG) (2008-2009) dhe detyrën si zëvendësues për operacionet në misionin e BE-së, ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë (2010-2011). Ai ka shërbyer si atashe ushtarak i



Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Republikën e Turqisë, jo rezident në Republikën e Izraelit, Gjeorgjisë dhe Azerbajxhanit (2017-2019), gjeneral brigade Sallaku dha një kontribut të shtuar në projektet modernizuese të FA-së, nëpërmjet granteve të dhëna nga Forcat e Armatosura të Turqisë dhe koordinimit për kontingjentet e përbashkëta me Turqinë për misionet ushtarake në Afganistan.

Gjeneral brigade Sallaku ka qenë një ndër ekspertët më të spikatur në fushën e logjistikës në Forcat e Armatosura. Kontributi i tij në përbushjen e standardeve të NATO-s në fushën e Logjistikës, bazohej në ekspertizën e fituar nga pjesëmarrja në

një numër trajnimesh në fushën e logjistikës dhe mbrojtjes në Turqi, Francë, Gjermani. Ndjekja dhe përfundimi me rezultate të larta i Akademisë së Luftës dhe Kolegjit të Lartë për Sigurinë në Turqi, e përgatitën atë si drejtues dhe për të marrë detyra të nivelit strategjik, të cilat ai i realizoi me sukses deri në ditët e fundit para infektimit me COVID-19. Presidenti Ilir Meta i ka akorduar Dekoraten e lartë "Nderi i Kombit", gjeneralit Ndriçim Sallaku. Në njoftimin e plotë të Presidentit Ilir Meta thuhet: "Në vlerësim të veprës së çmuar e të gjithanshme, si një ushtarak model dhe i shkëlqyer karriere, për modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare dhe me mirënjohje shtetërore për vlerat atdhetare e njerëzore, që shpalosi gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe shkencore, si dhe ndaj kontributit të qenësishëm në zhvillimin, lartësimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të ushtarakëve tanë në uniformë, duke u shërbyer me dinjitet dhe krenari demokracisë e vlerave të paqes në radhët e Aleancës së NATO-s, pata privilegjin t'i akordoj sot Dekoraten e lartë "Nderi i Kombit", Gjeneral Brigade Ndriçim Sallakut".

Ushtaraku Xhevahir Jazaj humbi jetën në Afganistan

Qeveria ka vendosur të akordojë një fond prej 10 milionë lekësh në ndihmë të familjarëve të ushtarakut Xhevahir Jazaj, i cili humbi jetën gjatë një misioni ushtarak në Afganistan. Në vendimin e këshillit të ministrave thuhet se ky fond do të përballohet nga buxheti i vitit 2021. Për zbatimin e këtij vendimi është ngarkuar Ministria e Mbrojtjes.

"Vendim për kompensimin e veçantë të familjes së ushtarakut, i cili humbi jetën gjatë kryerjes së detyrës në mision ushtarak jashtë vendit. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ush-

Qeveria akordon 10 milionë lekë për familjen e tij

tarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi: Kompensimin e veçantë të familjes së ushtarakut, major Xhevahir Lefter Jazaj, i cili humbi jetën gjatë kryerjes së detyrës në mision ushtarak jashtë vendit, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë. Fondi i përcaktuar

në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor "Forca e luftimit". Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare", thuhet në vendim. 50 vjeçari Xhevahir Jazaj, humbi jetën në Janar të këtij viti në Afganistan, në rrethana të paqarta. Jazaj është ushtaraku i dytë shqiptar i cili ka humbur jetën në një mision në Afganistan.

Norvegjezët modernizojnë Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake



HAJRIE DEDAJ

Në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze për projektin e hartave detare. IGJIU ka planifikuar të realizojë aktualisht tre lloje hartash detare elektronike ENC, që janë të tipit Coastal (hartat që përfshijnë të gjithë ujërat detarë të vendit tonë) me shkallë 1:90000, harta Approach (hartat e afërimit për në port) me shkallë 1:22000 dhe hartat Harbour (hartat portuale) me shkallë 1:4000. Deri më tani janë realizuar harta Coastal dhe Approach dhe janë duke u realizuar hartat Harbour.

Pak fjalë për historikun e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake

Punimet e para gjeodezike në Shqipëri zënë fill në vitet 1918-1927 me punimet e Institutit Gjeografik të Vjenës. Në përfundim të Luftës së Parë Botërore ky institut botoi 22 fletë harte të territorit të Shqipërisë në shk. 1:75.000 të krijuara me metoda të drejtpërdrejta matjesh në terren. Në 17 shtator 1927 krijohet grupi i parë gjeodezik me 13 specialistë. Detyra e këtij shërbimi ishte plotësimi i nevojave të ushtrisë me harta dhe materiale hartografike, organizimi i

Projekti ka bërë të mundur që vendi ynë të ketë për herë të parë harta elektronike të navigimit ENC, të cilat janë në shitje për përdoruesit që nga janari 2019. Në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze me vlerë 1.2 milionë euro për projektin e hartave detare. Ndërkohë vazhdon bashkëpunimi me Qendrën e Informacionit Gjeotopografik dhe Aeronautik të Italisë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore shk. 1:250.000. V



përgatitjes topografike të ushtarakëve, sigurimi i bazamentit të nevojshëm gjeodezik për nevoja të ushtrisë etj. Instituti Topografik i Ushtrisë u krijua në 8 Mars të vitit 1975 me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me qendër në Tiranë. Në këtë vendim përcaktohet se ITU është një institucion ushtarak, kërkimor e prodhues në fushën e përgatitjes gjeografike të

ushtrisë shqiptare. Ai u krijua nga bashkimi i dy repartëve, repartit i Topografisë dhe ai i Hartografisë, të cilët kishin ushtruar aktivitetin e tyre, që nga dhjetori i vitit 1961. Në qershor të vitit 2012, IGJU kaloi në varësi të MM-së dhe në qershor të vitit 2014 me rastin e kalimit në strukturën e re organizative, IGJU bashkohet me ISPMB dhe merr emrin "Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastruk-

turës Ushtarake". Krijimi dhe veprimtaria e ITU-së sot IGJUI, janë pjesë e një mesazhi në ngritje, me përpjekje, me realizime, probleme studimore, zbatime e në reformim të vazhdueshëm.

Instituti i "Gjeografisë dhe Infrastruktura Ushtarake" të hënën, me 8 mars 2021, shënoi 46 vite të krijimit të tij. Ashtu si çdo institucion është përbalhur me vështirësi gjatë rrugëtimit, por ka arritur të përmbushë më së miri misionin e tij; mbështetjen gjeografike të veprimeve ushtarake të Forcave të Armatosura. Gjithashtu Instituti kryen veprimtari në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë kombëtare në fushat e gjeodezisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe remonte-sensing. Gjatë gjithë viteve në "Institutin e Gjeografisë dhe Infrastruktura Ushtarake" janë realizuar disa projekte të rëndësishme si ai i krijimit të Rrjetit të ri gjeodezik të Shqipërisë i cili përfundoi në vitin 1986 si dhe krijimi i Rrjetit të ri të nivelacionit shtetëror i cili përfundoi gjatë viteve 1971-1987. Vlen të përmendet dhe vepra e madhe që ka kryer Instituti Topografik i Ushtrisë në fushën e hartografisë, krijimi i hartave të shkallës 1:25.000. Një tjetër projekt madhor është ai i parametrave të Transformimit në vitin 2007, parametrat e transformimit të koordinatave nga sistemi shtetëror ALB 87 në sistemin global ETRF 2000.

Shërbimi Hidrografik i Mbretërisë së Norvegjisë më i rëndësishmi në projektin e hartave detare

Për një informacion më të detajuar dhe për tu njohur me ecurinë e projekteve vizituam ambientet e Institutit dhe kuptuam se bashkëpunimi për projektin ALNO-HIP (Albanian-Norwegian Hydrographic Information Project) me Shërbimin Hidrografik të Mbretërisë së Norvegjisë është më i rëndësishmi që IGJUI ka patur vitet e fundit.

Ky projekt ka filluar më 27.11.2014 me nënshkrimin e marrëveshjes dypalëshe në Tiranë nga Sekretari i Përgjithshëm i MM-së për Palën Shqiptare dhe Drejtori i Shërbimit Hidrografik Norvegjez për palën Norvegjeze. Ky projekt konsiston në ndihmën nga pala norvegjeze për rritjen e kapaciteteve të IGJUI-së dhe Shërbimit Hidrografik Shqiptar për krijimin e hartave detare elektronike ENC (Electronic Navigation Charts) dhe hartave detare në letër. Zbatimi i projektit ALNO-HIP ka filluar në periudhën shkurt-prill 2015 me realizimin e specifikimeve teknike të software-it dhe hardwareve, që do të bliheshin për realizim e projektit. Në muajin gusht 2015 është bërë instalimi i softwarit Teledyne CARIS dhe për një periudhë nga shtatori deri në dhjetor 2015 janë kryer trajnime për programin nga kompania fituese pranë ambienteve të IGJUI-së. Janë përpiluar ENC e hartës

detare Approach të shkallës 1:22 000 AL400001, AL400002, AL400003 si dhe Coastal të shkallës 1:90000 AL300001, të projektit ALNO-HIP. Gjithashtu trajnime të tjera në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar nga personeli pranë zyrate të IGJUI-së, por edhe në Norvegji dhe Itali. Projekti është drejt përfundimit me palën Norvegjeze. Ky projekt me investimin rreth 1.2 milion euro, ka bërë të mundur rritjen e kapaciteteve me pajisje dhe programe kompjuterike moderne e bashkëkohore të standardeve ndërkombëtare.

Projekti ka bërë të mundur, që vendi ynë të ketë për herë të parë harta elektronike të navigimit ENC, të cilat janë në shitje për përdoruesit që nga janari 2019, por gjithashtu edhe pajisje dhe personel të trajnuar për të realizuar hartat detare, sipas standardeve ndërkombëtare të IHO-s (International Hydrographic Organization). IGJUI ka planifikuar të realizojë aktualisht tre lloje hartash detare elektronike ENC që janë të tipit Coastal (harta që përfshijnë të gjithë ujërat detarë të vendit tonë) me shkallë 1:90000, harta Approach (hartat e afërimit për në port) me shkallë 1:22000 dhe hartat Harbour (hartat portuale) me shkallë 1:4000. Deri më

në Shqipëri, me përgjegjësinë e prodhimit të hartave tokësore, detare dhe ajrore, në shkallë të ndryshme. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projekt/preventivave të zbatimit për projektet infrastrukturale të MM-së dhe SHPFA-së. Prodhon dhe mirëmban material hartografik në mbështetje të FA-së dhe institucioneve të administratës publike si dhe sistemit arsimor dhe biznesit. Nëpërmjet sektorit të menaxhimit të arkivit, ofron shërbime për MM-në dhe SHPFA-në, Administratën Publike me material hartografik, fotografi ajrore, projekte inxhinierike, etj. Shërbimet që ofron IGJUI janë harta detare, harta tematike, harta topografike të standardeve të NATO-s. Fragmente të skanuara nga hartat e vjetra me rëndësi historike kombëtare të vërtetuara me origjinalin. Harta të Kufirit të hartuara nga Komisioni i Kufijve shk. 1:50.000, v.1922-1925 Fragmente të skanuara nga fotografitë ajrore të vërtetuara me origjinalin. Fotografi ajrore të viteve '50-'60, fotografi ajrore të viteve '70-'90, fotografi ajrore të vitit 1994. Bashkëpunon me institucionet e linjës përgjegjëse për infor-



tani janë realizuar harta Coastal dhe Approach dhe janë duke u realizuar hartat Harbour. Gjithashtu janë planifikuar që të realizohen edhe harta në letër të tipit Approach dhe Harbour.

Instituti shqiptar zotëron statusin e Agjencisë Hartografike Kombëtare në Shqipëri

Sipas institutit, në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze për projektin e hartave detare. Aktualisht nuk ka bisedime për bashkëpunim tjetër me palën Norvegjeze për ndonjë projekt në lidhje me hartat ajrore apo tokësore, por instituti mbetet i hapur për mundësinë e një bashkëpunimi të tillë i cili do të ishte shumë ndihmues për IGJUI-në. IGJUI mbulon me harta gjithë ushtrinë, si pasojë Instituti zotëron statusin e Agjencisë Hartografike Kombëtare

macionet në lidhje me zonat bregdetare të mbrojtura, zonat e ndaluara të peshkimit, zonat e parashikuara për ankorim si dhe të dhëna të tjera në mbështetje të hartave detare.

Bashkëpunim me Italinë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore

Ndërsa Instituti i Gjeografisë dhe Infrastruktura Ushtarake është në përfundim të projektit shtatëvjeçar me Norvegjezët për hartimin e hartave detare, aivijon bashkëpunimin me Qendrën e Informacionit Gjeotopografik dhe Aeronautik të Italisë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore shk.1:250.000. Të gjithë projektet e lartpërmendur, që IGJUI ka realizuar ndër vite e bën atë të jetë një institucion i rëndësishëm jo vetëm për Forcat e Armatosura, por për të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Zeno Jahaj dhe libri doktrinë për gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Prezantim me autorin

Zeno Jahaj ka lindur më 5 shkurt 1952 në Mesaplik, Vlorë. Familja e tij është e njohur në zonën e Mesaplikut për tradita patriotike dhe bujari. Pas përfundimit të shkollës 7 vjeçare në fshat, në vitet 1966-1970 kreu studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", më pas ndoqi studimet në vitet 1970-1973 në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, si dhe kurs për zbulimin ushtarak. Akademinë Ushtarake do ta bënte në vitet 1987-1988. Ka ndjekur në vitin 1997 kursin e Lartë në Kolegjin e NATO-s, në Romë. Ndërsa në vitet 2011-2013 ka ndjekur studimet për master në Sigurinë Kombëtare në Akademinë e Mbrojtjes. Me përfundimin e shkollës dhe titullimin oficer në vitet 1973-1984 ka kryer detyra komanduese e mësimdhënëse në njësi e shkolla ushtarake. Ndërsa në vitet 1984-1993, 1997-1998 ka kryer detyrën e oficerit të shtabi në Shtabin e Përgjithshëm. Në vitet 1998-2003, ka kryer detyrën e atasheut ushtarak-këshilltar diplomatik, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Greqisë. Në vitet 2003-2008 ka kryer detyrën e shefit të kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe në vitet 2008-2010 ka qenë këshilltar ushtarak i Ministrit të Mbrojtjes. Ka marrë gradën ushtarake Kolonel.

Risite e reja të një libri për gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake

Koloneli Zeno Jahaj paraqitet para lexuesit ushtarak dhe civil me një libër të titulluar "Gjeopolitika dhe Fuqia Ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë". Është një libër voluminoz, me një përmbajtje dhe qartësi mendimi për gjeopolitikën dhe fuqinë ushtarake të Shqipërisë në periudhën e quajtur Lufta e Ftohtë. Libri për nga trajtesa e këtij problemi, por dhe nga analiza e thellë dhe e mbështetur në literaturë të kohës dhe në mendimin e mjaft personaliteteve ushtarake dhe politike botërore, është një doktrinë për gjeopolitikën. Materiali i bollshëm dhe argumentet e thella dhe të bazuara në realitetin e kohës, e bëjnë librin një prurje të re në literaturën ushtarake, por dhe atë të diplomacisë, si dhe në fushën politike.

Autori në këtë libër mbi bazën e pozitave ushtarake, të diplomacisë dhe të botëkuptimit të tij, bën analizën dhe vlerësimin e gjeopolitikës dhe të fuqisë ushtarake të Shqipërisë në Luftën e Ftohtë. Ky libër nga problematika që



trajton duhet të jetë në qendër të diskutimeve për problemin e gjeopolitikës dhe të fuqisë ushtarake në FA. Libri i Zeno Jahaj, jo vetëm që shpreh mendimet e pikëpamjet e kohës si në fushën ushtarake, ashtu edhe në atë politike të Shqipërisë, por edhe është një kontribut i madh në studimin e mëtejshëm të problemeve ushtarake. Ky libër për shkollën ushtarake shqiptare do të ndikojë së tepërmi në përpunimin dhe pranimin e parimeve të cilat mbështeten nga politika ushtarake e Shqipërisë. Dëshmi e qartë për këtë ishin veprimet politike ushtarake të Shqipërisë në Luftën e Ftohtë. Perdja e hekurt e Luftës së Ftohtë, ishte vija e parë e mbrojtjes midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Shqipëria mbeti në një brez shtetesh përkatej perdes së hekurt. Ky brez përbëhej nga Greqia (anëtare e NATO-s) dhe Jugosllavia (në heshtje, partnere e NATO-s). Në këto kushte, Traktati i Varshavës as nuk e mbronte, as nuk e sulmonte Shqipërinë, pa u përplasur paraprakisht me NATO-n. Në rast të një agresioni ndaj Shqipërisë, në drejtimin tokësor, forcat ushtarake të Traktatit të Varshavës do të përballeshin më parë me forcat ushtarake të Greqisë dhe Jugosllavisë. Ndërsa në drejtimin detar, ato do të përballeshin me Flotën e Gjashtë Amerikane të Mesdheut. NATO dhe SHBA e monitoronin nga afër Shqipërinë me anë të organizmave, agjensive të zbulimit dhe komandave ushtarake. Në të njëjtën kohë, në libër zbulohen

qartë pikëpamjet zyrtare të Shqipërisë në Luftën e Ftohtë, mbi mënyrat, format dhe metodat e bërjes së saj. Libri paraqet interes teorik dhe praktik në njohjen e parimeve ushtarake, të koncepteve, të skenarëve të mundshëm, të teknikës luftarake etj. Që në fillim autori thekson se fuqia ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë, dukej si një mani madhështie dhe, për këtë arsye, një temë e frikshme për t'u trajtuar, pasi disa e kanë tejëlvdur dhe përcmuar. Identifikimi i fuqisë ushtarake të Shqipërisë në Luftën e Ftohtë, paraqitet i vështirë sepse, fuqia nuk u provua. Kjo temë ka hije të frikshme, nga mosnjohja, por dhe nga politika. Kombet që kanë respekt për veten, duhet të kenë fuqi dhe ta njohin fuqinë e tyre. Në Shqipëri studimit të doktrinë ushtarake dhe të politikës ushtarake nuk i kushtohet vëmendje e duhur. Ndaj dhe ekziston gjerësisht mendimi se për mbrojtjen kombëtare nevojiten resurse të mjaftueshme njerëzore dhe sasi e caktuar armatimi dhe teknike. Këta faktorë sot nuk sigurojnë organizimin ushtarak.

Ky libër, studim ushtarak i shkruar nga kolonel Zeno Jahaj, mbi zhvillimin e gjeopolitikës dhe fuqisë ushtarake, mund dhe duhet të shërbejë si bazë për ata që dëshirojnë të studiojnë më tej në këto çështje. Për studentët që fillojnë për të parën herë të studiojnë politikën ushtarake, në librin "Gjeopolitika dhe Fuqia Ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë", ka një tregues mjaft të gjerë të literaturës, që do t'i ndihmojë në pasurimin dhe thellimin e këtyre çështjeve. Libri paraqet interes edhe për ata që tani përcaktojnë politikën ushtarake të Shqipërisë dhe garantojnë sigurinë e vendit tonë. Ky libër duhet të lexohet dhe të studiohet nga studentët ushtarakë dhe nga civil, që merren me problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes, pasi mund të orientohen më mirë në problemet që qëndrojnë përpara nesh.

Luftë plot mëdyshe

Autori në hyrje të librit thekson se "Lufta e Ftohtë mbetet edhe sot një term disi i çuditshëm". Këtë term e ka përdorur shkrimtari anglez, Xhorxh Oruell në vitin 1945, ku paratheksonte se superfuqitë do binin dakord që të mos e "shkrejnë" bombën atomike kundër njeri-tjetrit. Ajo do përdorej prej tyre si mjet frikësimi në Luftën e Ftohtë. Ndërsa Bernard Baruh, në vitin 1947, me thirrjen "të mos mashtrohemi: ne jemi sot në mes të një Luftë të Ftohtë". Lufta e Ftohtë ishte dhe nuk ishte paqe, ajo sipas autorit ishte një ankh luftë në mendjet dhe zemrat e njerëzimit. Vende të mëdha dhe të vogla hynë, nisën startin për të fituar më shumë fuqi ushtarake. Të gjithë ishin në luftë, por nuk ishte shpallur gjendja e luftës. Fuqia ushtarake e çdo vendi kushtëzohej nga strategjia ushtarake, koncepti dhe arti i zhvillimit të operacioneve, organizimi ushtarak, arsimimi ushtarak, stërvitja dhe gatishmëria luftarake, fuqia njerëzore, armatimet, teknika dhe teknologjia, logjistika, fortifikimi e zbulimi ushtarak. Të gjithë këta përbërës, ose harmonizoheshin ose rrëzonin njeri-tjetrin. Por ndërthurjen e fuqisë e bën lidhshpër civil dhe ushtarak. Ata përcaktojnë rreziqet dhe kërcënimet, ndërtojnë strategji dhe planifikojnë operacione. Lidhshpër ka buxhetin dhe burimet e mbrojtjes, ndërton forcën ushtarake për luftën ndaj kundërshtarëve të rreziqshëm dhe kërcënimeve të kombit. Fuqia thekson autori nuk mund të matet pa skenarë të besueshëm, sepse edhe Lufta e Ftohtë ishte e pabesë.

Problemet kryesore që trajtohen

Libri është i ndërtuar në disa krerë, ku në kreun e parë trajtohen rreziqet dhe kërcënimet strategjike për mbrojtjen e vendit, trajtohen mjedisi gjeopolitik i Luftës së Ftohtë, rreziqet dhe kërcënimet ushtarake të përcaktuara nga lidhshpër i kohës, si dhe kërcënimet dhe rreziqet ushtarake të mundshme. Lufta e Ftohtë u shndërrua në konflikt ideologjik vlerash politike dhe ekonomike, dhe u shpreh në konflikt gjeopolitik e ushtarak midis Bashkimit Sovjetik, fuqi e madhe tokësore dhe SHBA-së, fuqia e madhe detare. Shqipëria qe produkt gjeopolitik i Luftës së Dytë Botërore.

Lidhshpër politik i saj i paraqiste rreziqet dhe kërcënime ndaj vendit, si ndaj komunizmit shqiptar.

Në kreun e dytë të titulluar diplomacia në tregun gjeopolitik, trajtohen problemet nën pagëzimin ideologjik francez, vërbulla gjeopolitike e Luftës së Dytë Botërore, gjeopolitika në themelet shqiptare të para Luftës së Ftohtë, harta gjeopolitike që bëri përjashtimi, lavjerrësi politiko-diplomatik shqiptar në Luftën e Ftohtë. Njerëzimi vuajti nga luftërat botërore sepse u udhëhoq nga përparësia e forcës ushtarake nga instrumentat e tjerë të shtetit, ndërsa Lufta e Ftohtë rëndësi kryesore i dha diplomacisë.

Burimet e fuqisë, është trajtuar në kreun e tretë, duke u ndalur në çështjet: gjeografi, burimet natyrore, zhvillimi ekonomik dhe kapaciteti industrial, karakteri dhe morali kombëtar, ideologjia komuniste: shpresa dhe zhgënjimi, si dhe kapacitetet institucionale të shtetit. Autori trajton se në këndvështrimin e fuqisë që buron nga zhvillimi ekonomik, Shqipëria, ka potenciale të pasura me burime natyrore. Regjimi i izoluar nuk i përktente burimet në mirëqenie. Morali i popullsisë kushtëzohej nga regjimi politik. Me fillimin e vetizolimit, ku ekonomia socialiste nuk prodhonte, shpresat përfunduan në zhgënjim.

Kreu i katërt i kushtohet strategjisë dhe doktrinë ushtarake, ku trajtohet strategjia ushtarake, operacionet, luftimi, strukturat organizative, arsimimi, stërvitja dhe gatishmëria luftarake. Strategjia ushtarake e Shqipërisë pasqyrore synimet për të përballuar rreziqet, kërcënimet dhe rrethimin armiqësor të përceptuar nga lidhshpër. Ajo u orientua nga alternativa e mbështetjes tërësisht në forcat e veta dhe përgatitjes për luftë të gjatë në rrethim.

Fuqia ushtarake trajtohet në kreun e pestë dhe trajton çështjet e buxhetit të mbrojtjes, buxhetit të luftës, fuqia njerëzore: një popull i tërë nën armë, disiplina dhe morali ushtarak, armatimet, teknika dhe teknologjia: sasia kundër cilësisë, fortifikimi, logjistika, zbulimi ushtarak dhe lidhshpër politik-ushtarak. Fuqia ushtarake e Shqipërisë qëndronte kryesisht në masivizimin e çështjes së mbrojtjes, në ndërgjegjësimin dhe në mobilizimin ushtarak. Shpenzimet ushtarake të Shqipërisë ishin më të larta se ato të shteteve të tjera. Por, në luftë janë cilësia dhe teknologjia që krijojnë avantazhet strategjike. Fortifikimet e përhershme ofronin besim, por ky harxhim varfëroi investimet për njerëzit, oficerët e ushtarët, modernizimin e teknikave dhe teknologjisë ushtarake. Luftërat provojnë se investimi të njerëzimit dhe në teknologji prodhon fuqi të përjetshme. Investimet në fortifikime të përhershme prodhoi vetëm njëfuqi të përkohëshme. Logjistika, si shprehje thelbësore e fuqisë ushtarake dhe pasqyrë e drejtpërdrejtë e fuqisë ekonomike, do të gjendej e varur nga qëndrueshmëria e një vendi krejtësisht të izoluar dhe të vetizoluar.

Në kreun e gjashtë me objekt: Shqipëria në syrin e aleancave ushtarake, trajtohen çështjet në vëmendjen e NATO-s dhe SHBA-së, Traktati i Varshavës në hall me Shqipërinë. Në arkivat e NATO-s për veprimtarinë politike e ushtarake të periudhës së Luftës së Ftohtë, dikur të klasifikuara "teper sekret", tanimë janë deklasifikuar. Këto arkiva, flasin se NATO, përkundër Traktatit të Varshavës, nuk ishte e pandjeshme ndaj zhvillimeve në Shqipëri. Shqipëria ishte pjesë integrale e axhendës së analizës, vlerësimit dhe parashikimit ushtarak e politik të NATO-s. Ndërkohë, Shqipëria, së bashku me Republikën Demokratike Gjermane, do të përbënin një rast të dyshimtë në Traktatin e Varshavës. Udhëheqës të lartë sovjetikë ishin skeptikë në praninë e këtyre dy shteteve në Traktatin e Varshavës, duke shtruar pikëpyetjen: "Pse ne duhet të kryejmë luftë në emër të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermane?!".

Libri është i shkruar me një gjuhë të thjeshtë dhe fjalitë janë të ndërtuara rrjedhshëm, problemet dhe argumentat e hedhura në faqet e librit e bëjnë leximin më terheqës. Libri ka të dhëna për mjaft nga çështjet sot më të debatueshme për periudhën e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë.



Në ambientet e Kazermës "Adem Jashari" u zhvillua ceremonia e dërgimit të kontingjentit të parë të trupave ushtarake të FSK-së, për një periudhë 6 mujore, në misionin paqeruajtës në kuadër të trupave ushtarake amerikane të Gardës Kombëtare të Iowa-s, për në Shtetin e Kuvajtit. Në ceremoninë përkatëse, të pranishëm ishin Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ministri i Mbrojtjes në detyrë, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, si dhe zyrtarë diplomatikë e ushtarakë vendor e amerikan si dhe shteteve tjera partnere.

Pas lutjeve të kapelanit të FSK-së, rreshter major Agim Gashi, për ushtarakët e kontingjentit për dislokim, Presidentja Osmani në fjalën e saj shprehu impresionet e saj për këtë ngjarje historike për vendin dhe partneritetin strategjik me SHBA-në.

Presidentja Vjosa Osmani tha se: "Ky mision gjashtë mujor i ushtarëve tanë po bëhet i mundshëm falë partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, respektivisht me Ushtrinë Amerikane, ndaj paqeruajtësit tanë do të jenë krah tyre në këtë mision fisnik. Programi i partneritetit shtetëror me Ushtrinë Amerikane ka qëllim afatgjatë, dhe ka për qëllim krijimin dhe zgjerimin e partneritetit me FSK-në, në funksion të promovimit të sigurisë rajonale, por edhe më gjerë. 22-vjet më parë ishte vështirë e imagjinueshme se ushtarët tanë do të mund të ishin pjesë e ndonjë misioni paqeruajtës në botë. Sot kjo gjë po bëhet realitet, sepse ne e bëmë lirinë dhe e ndërtuam paqen bashkë edhe me miqtë tanë ndërkombëtarë. Tashmë erdhi koha që t'ua kthejmë një pjesë të kontributit të tyre, duke u bërë partner në ndërtimin dhe në ruajtjen e paqes. Ky kontingjent që po e dërgojmë në Shtetin e Kuvajtit është i vogël në numër, por i madh në përmbajtje dhe në mesazh. Këta



Pjesë e trupave ushtarake amerikane të Gardës Kombëtare të Iowa-s

Kontigjenti i FSK niset me mision ndërkombëtar në Shtetin e Kuvajtit

Ky mision gjashtë mujor i ushtarëve të FSK bëhet i mundshëm falë partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

djem po e shkruajnë historinë e re të Forcës sonë.

Edhe ministri Quni dhe gjeneral Rama, theksuan rëndësinë historike të ngjarjes për Kosovën, FSK-në dhe të ardhmes së saj. Ata shprehën mirënjohjen e lartë për mbështetjen e pakursyer të shtetit, kombit dhe forcave amerikane për të arritur të deritashme të FSK-së në forca moderne ushtarake me standardet më të larta profesionale. Kjo mbështetje nga të tre u vlerësua jetike për FSK-në që të jetë e gatshme për të përmbyshur detyrat kushtetuese dhe ligjore të saj, ndër të cilat edhe pjesëmarrjen efektive në misionet paqeruajtëse dhe stabilitetit jashtë vendit. Ata kërkuan nga ushtarakët e kontingjentit për dislokim që të udhëhiqen gjithmonë nga vlerat dhe standardet më të larta të ushtarakut që janë të përputhshme plotësisht me vlerat historike të kulturës dhe traditës kombëtare si: besnikëria, detyra, respekti, shërbimi vetëmohues, nderi, integriteti dhe guximi personal. Këtu u vlerësuan fuqia e natyrshme e ushtarakut në shërbim të drejtësisë, lirisë, barazisë dhe demokracisë, vlera këto të përbashkëta të popullit amerikan dhe popullit të Kosovës.

Përmes video-mesazhit të pran-

ishmëve iu drejtua edhe komandanti i Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneral major Benjamin J. Corell, i cili theksoi se bashkë-dërgimi i kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës me forcat amerikane të udhëhequra nga ai demonstroi fuqishëm gatishmërinë e FSK-së për të ofruar kontributin për paqen, sigurinë dhe stabilitetin kudo në botë. Krahas lutjeve edhe të kapelanit të Gardës Kombëtare të Iowa-s, major Sleton, në fund të gjithë uruan ushtarakët e kontingjentit që të shërbejnë me dinjitet dhe profesionalizëm për të nderuar Atdehun, Kombin, Flamurin dhe Emblemën e FSK-së si dhe besimin e përjetshëm të miqve tanë amerikan.

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht një njësi e saj do të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse jashtë vendit krahas ushtrisë amerikane. Kjo marrëveshje, dy muaj më parë u ratifikua në Parlamentin e Kosovës dhe shënon për herë të parë angazhimin e trupave të saj në një mision ushtarak paqeruajtës jashtë vendit. Kontingjenti i FSK-së, i integruar në trupat e Gardës Kombëtare të Iowa-s, do të operojë në Komandën Qendrore të Forcave Amerikane, e cila ka përgjegjësi në zonën gjeografike ku përfshihet Lindja e Mesme, një pjesë e Azisë Jugore dhe Afrika Verilindore.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama vizitë zyrtare katërditore në Itali

Me ftesë zyrtare të homologut të tij Gjeneral Pietro Serino, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ishte në vizitë zyrtare katërditore në Republikën e Italisë. Me këtë rast, me nderimet më të larta ushtarake, ai u prit nga autoritetet më të larta ushtarake italiane. Në takimet përkatëse u diskutua për format e implementimit të planit të veprimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes të dy forcave. Nga ana e tij, gjeneral Rama, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë të shtetit dhe forcave italiane për rolin e tyre të madh në kuadër të misionit të KFOR-it në përgjithësi si dhe për kontributin e madh për ndërtimin, zhvillimin dhe të arriturat e deritashme të FSK-së në veçanti.

Gjithashtu, gjeneral Rama i njohu me progresin e FSK-së në realizimin e Planit Gjithëpërfshirës

Në takimet përkatëse u diskutua për format e implementimit të planit të veprimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes të dy forcave



të Tranzicionit, kapaciteteve aktuale dhe ngritjes së kapaciteteve mbrojtëse duke theksuar nevojën dhe rëndësinë e mbështetjes nga pala italiane në këtë aspekt. Me këtë rast ai, theksoi objektivin strategjik për të ndërtuar forcat ushtarake sipas standardeve më të avancuara dhe të ndërveprueshme me forcat e vendeve të NATO-s, për të qenë të përshtatshme për operacione të përbashkëta paqeru-

ajtëse. Nga ana e autoriteteve italiane, u vlerësuan lart të arritjet e deritashme të FSK-së, si forcë profesionale në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës si dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në fund të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në mes të dy forcave të thellohet dhe intensifikohet edhe më tej në fushat me interes të përbashkët.

UNË I PËRULEM ME SHPIRT E ZEMËR FLAMURIT KOMBËTAR

Armend Metaj, ministri i Mbrojtjes i Kosovës

Armend Mehaj është emri që do të drejtojë Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës në qeverinë "Kurti 2". Ai ka lindur në vitin 1981 në Kosovë dhe aktualisht jeton në Oslo të Norvegjisë. Në vitin 1999 i është bashkuar forcave të armatosura Norvegjeze, për të shërbyer më pas në misione të ndryshme paqeruajtëse si në Kosovë, Irak, Afganistan, Çad dhe Afrikën Qendrore. Mehaj do të zëvendësojë në krye të ministrisë së mbrojtjes Anton Qunin, i cili u betua si deputet i Kosovës nga rradhët e LDK-së.

Ai ka lindur në vitin 1981 në Kosovë dhe aktualisht jeton në Oslo të Norvegjisë, ku është pjesë e forcave të armatosura Norvegjeze

Në 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, Kapiten Mehaj ishte dekoruar nga Shtabi i Përgjithshëm i FARSH-së, me medaljen "Për shërbime të veçanta, me motivacionin "Për shërbime të merituar në detyrat me përgjegjësi të lartë, si dhe në kontributin e veçantë të dhënë në përmbushje me sukses të misionit paqeruajtës të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Çad". Me këtë

rast, Mehaj kishte deklaruar se dashurinë për vendlindjen e tij Kosovën, për Shqipërinë dhe kombin shqiptar e ka të shenjtë. "Ndjehem i privilegjuar që marr këtë dekoratë në këtë 100 vjetor të Pavarësisë. Unë jam nga Kosova dhe dashurinë për vendlindjen, për Shqipërinë dhe kombin shqiptar e kam të shenjtë. Unë i përulë me shpirt e zemër flamurit kombëtar", ishte shprehur Mehaj.

Me rastin e njëvjetorit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, Presidenti Pendarovski Stevo Pendarovski bëri bisedë telefonike me Sekretarin e përgjithshëm, Jens Stoltenberg. Në këtë bisedë dy bashkëfolësit shkëmbyen mendime mbi rolin e Aleancës dhe ballafaqimin me sfidat e ardhshme të sigurisë, për stabilitetin rajonal dhe për prioritetet e jashtme politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në këtë kontekst, Presidenti Pendarovski shprehu falënderim për mbështetjen të cilën vendi e merr nga NATO, Zyra për siguri në procesin e certifikimit të personave zyrtarë në shtet për të cilët kërkohet certifikatë e sigurisë e NATO-s. Të dy bashkëfolësit ranë dakord se ky është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe se duhet të vazhdojë në të gjitha segmentet e domosdoshme vitale si për sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe për sigurinë e Aleancës.

Njëkohësisht, Presidenti Pendarovski shprehu falënderim edhe për ndihmën e deritanishme në ballafaqimin me pasojat e pandemisë së Covid-19, duke thënë se solidariteti dhe mbështetja nga vendet aleate është e domosdoshme për tejkalimin e sfidave të reja reale me të cilat po ballafaqohet Evropa dhe bota.

Maqedonia e Veriut e përkushtuar ndaj reformave në mbrojtje

Presidenti Pendarovski: “Dokumenti NATO 2030, përcakton të ardhmen e Aleancës së NATO-s, në të cilën jemi dhe ne, anëtare e plotfuqishme nga marsi i vitit të kaluar”

Në këtë bisedë telefonike, Presidenti Pendarovski e riafirmoi përgatitjen dhe përkushtimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në promovimin e paqes dhe stabilitetit, duke theksuar se vendi edhe të të ardhmen do të kontribuojë aktivisht në misionet ndërkombëtare paqësore, në rajon dhe më gjerë, të udhëhequra nga NATO. Maqedonia e Veriut, -shtoi Presidenti Pendarovski, -mbetet tërësisht e përkushtuar ndaj reformave në mbrojtje dhe në siguri në përputhje me standardet e NATO-s.

Të dy bashkëfolësit biseduan

edhe për dokumentin NATO 2030, i cili duhet të përcaktojë të ardhmen e Aleancës së NATO-s, në të cilën jemi dhe ne anëtare e plotfuqishme nga marsi i vitit të kaluar. Më 18 mars 2020, përfundoi procesi i ratifikimit të Protokollit për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në NATO nga të gjitha vendet anëtare të Aleancës. Maqedonia e Veriut më 27 mars 2020 zyrtarisht u bë anëtarja e 30-të e NATO-s, pas deponimit të instrumentit të anëtarësimit në Traktatin e Atlantikut të Veriut në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, në Washington.



Tre shkencëtare në Qendrën e NATO-s për Kërkime Detare në Itali

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas të festuar në 8 Mars, tre gra që punojnë në Qendrën e NATO-s për Kërkime Detare dhe Eksperimentime (CMRE) në Itali, ndajnë historitë e tyre frymëzuese dhe shpjegojnë pse pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave është thelbësore në luftën për barazinë gjinore në Botë.


Kjo ditë ndërkombëtare synon të rrisë ndërgjegjësimin për perspektivat gjinore dhe parimet e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Më shumë rreth historive të tre shkencëtarëve që punojnë në një nga objektet kërkimore të NATO-s:

Pilar Caamaño Sobrino është një shkencëtare spanjolle e kompjuterit me një doktoraturë në Inteligjencën Artificiale. Në CMRE në La Spezia, ajo përqendrohet në zgjidhje të simuluar për testimin e sistemeve autonome në mjedis virtual, posaçërisht automjeteve nënujore autonome.

"Sistemet autonome siç janë robotët inteligjentë në ujë janë teknologji të rëndësishme për aleatët e NATO-s. Ata mund të zvogëlojnë rrezikun për njerëzit duke kryer detyra të rrezikshme, dhe kjo veçanërisht vlen për fushën nënujore", thotë ajo. Flotat detare, industria dhe qendrat kërkimore po hetojnë se si të çojnë operacionet e ardhshme detare përpara, ku automjete të shumta nënujore autonome mund të punojnë në bashkëpunim me ndërveprimin minimal njerëzor. Modelimi dhe simulimi po provojnë të jenë një mbështetje e aftë. Për pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave, Pilar konsideron se "ajo që është e rëndësishme është që të gjithë në çdo shoqëri të kenë lirinë për të zgjedhur dhe për të jetuar ashtu si dëshirojnë. Historikisht, për gratë, kapërcimi i pabarazisë ka qenë i vështirë dhe paraardhësit e mi u desh të qëndrojnë për të drejtat e grave në mënyrë që unë të jem e lirë të zgjedh rrugën time."

Mesazhi që ajo do të donte t'u dërgonte grave dhe vajzave është se "Nëse doni të shkoni shpejt, shkoni vetëm. Nëse doni të shkoni larg, shkoni së bashku. Dëgjoni të tjerët, pavarësisht nga gjinia, kultura, moshë, pozicioni i tyre. Mësoni prej tyre."

Ines Borrione, ka një doktoraturë në oqeanografi dhe është një shkencëtare italiane që punon si oqeanograf fizik në CMRE. Ajo përpunon dhe analizon të dhënat oqeanografike të mbledhura gjatë provave detare të CMRE. "Disa operacione të NATO-s ndodhin në det, shpesh në rajone që nuk njihen mirë," shpjegon Ines. "Roli ynë si oqeanografë është që të rimarrim dhe analizojmë të gjitha të dhënat në dispozicion në mënyrë që të karakterizojmë dhe monitorojmë kushtet aktuale të oqeanit, duke kontribuar në parashikime të sakta



të shteteve oqeanike. Siguria dhe sukcesi i operacioneve të NATO-s, të cilat janë në interes të të gjithë qytetarëve të NATO-s, mbështeten në këto parashikime të sakta të shtetit oqean."

Si grua, ajo konsideron se pjesa më sfiduese në jetën e saj profesionale është gjetja e ekuilibrit më të mirë midis punës, karrierës dhe rritjes së familjes. Për të rritur më tej integrimin e grave, ajo mendon se, "opsionet si pushimi i gjatë ose fleksibël i prindërve, orari fleksibël i punës dhe telepunimi janë sigurisht një ndihmë e madhe. Këto janë të gjitha opsionet që kanë bërë një ndryshim për mua." Për brezin e ardhshëm të grave shkencëtare, Ines shpreh se çdo vështirësi e paparashikuar kurrë nuk duhet t'i ndalojë ato të ëndërrojnë dhe të kthejnë pritjet në realitet. "Kjo është

arsyeja pse unë gjithmonë i inkurajoj të gjithë të ndjekin ëndrrat e tyre. Si një vajzë e vogël dëshiroja të bëhesha shkencëtare dhe nënë. Sot jam shumë krenare që them se jam bërë të dyja!"

Francesca de Rosa, është një shkencëtare italiane që mban një doktoraturë në Inxhinierinë Elektronike dhe Telekomunikuese me një fokus në mjediset njohëse interaktive. Ajo po punon në projekte të ndryshme në lidhje me mbikëqyrjen detare dhe ndërgjegjësimin e situatës detare në CMRE. Fushat e saj kryesore të kërkimit përfshijnë sisteme njohëse, inxhinierinë e njohurive dhe integrimin e sistemit njerëzor. "Shumë nga detyrat njohëse mbi të cilat mbështetet vendimmarrja gradualisht po u delegohen makinave për të ndihmuar operatorët njerëzorë në mjedis të ndryshëm të punës si siguria, siguria, menaxhimi i krizave, shëndeti dhe ndihma e parë", thotë Francesca. Këto mjete për mbështetjen e vendimeve rrisin ndërgjegjësimin e situatës së operatorëve duke çuar në një vendimarrje më të mirë, më të shpejtë.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Francesca gjithmonë ka menduar se nuk është aq shumë për festë, por më tepër një ditë për rritjen e ndërgjegjësimin. "Duhet të na kujtojë se liria e zgjedhjes që gratë kanë në vendet tona nuk është e njëjtë në pjesët e tjera të botës. Duke parë vajzën time të re që po rritet, ndonjëherë e kam gjetur veten duke menduar se si do të ndihesha si nënë në një shoqëri ku ajo nuk është në gjendje të përmbushë potencialin e saj të plotë."

Qendra për Kërkime Detare dhe Eksperimentime (CMRE)

Qendra për Kërkime Detare dhe Eksperimentime, nën ombrellën e Organizatës së Shkencës dhe Teknologjisë së NATO-s, është një strukturë e themeluar, e klasit botëror për kërkime shkencore dhe eksperimentime e vendosur në La Spezia, Itali. CMRE organizon dhe zhvillon kërkimin shkencor dhe zhvillimin e teknologjisë, të përqendruar në fushën detare, duke dhënë zgjidhje inovative dhe të testuara në terren të Shkencës dhe Teknologjisë për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës.

Masa fortifikuese në Luftën e Shkodrës, 1912-1913

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Fortifikimi i teatrit të luftimeve

Një ndër shkaqet e qëndresës së pamposhtur të forcave mbrojtëse të qytetit të Shkodrës (rreth 20.000 luftëtarë shqiptarë dhe 4.000 ushtarëve turq) gjatë rrethimit 6 mujor nga trupat e 7 divizioneve serbo-malazeze në Luftën e Parë Ballkanike, 1912-1913, sipas pjesëmarrësve në këtë luftë dhe studiuesve, ishte fortifikimi i teatrit të luftimeve. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë turke, duke u nisur nga ideja e një lufte të mundshme me Rusinë dhe vendet ballkanike, filloi të mendojë për nevojën e një planëzimi të ri luftarak, i cili do t'i përgjigjej situatave kërcënuese që po përvijoheshin. Në fillim të vitit 1912, Shtabi madhor turk, duke parë dhe përgatitjet e Bullgarisë, Greqisë, Serbisë e Malit të Zi, përfundoi në vija të përgjithshme planëzimin luftarak.

Detyra e garnizonit osman të dislokuar në Shkodër, ishte që të mbronte me këmbëngulje dhe me çdo çmim Shkodrën dhe të pengonin suksesin ushtarak dhe politik të Malit të Zi deri në ardhjen e forcave kryesore osmane. Për këtë qëllim shtabi suprem kishte urdhëruar që Shkodra dhe Janina duhej të fortifikoheshin aq sa të ishin në gjendje që në mënyrë të pavarur (edhe në rrethim) të mbroheshin për një muaj e gjysmë. Më vonë, ky afat u zgjat deri në 6 muaj.

Fortifikimi i Shkodrës u ndërtua në përshtatje me veçoritë e terrenit malor, kodrinor, e fushor, e sidomos me pengesat e mëdha ujore, që është i pasur ky qytet si liqeni, lumenjtë Drini, Buna e Kiri. Mbi këtë bazë u ndërtua edhe sistemi i fortifikimit, i ndarë në zona. Zona e Shtojit që fillonte nga liqeni (Bishti i Qenisë) dhe përfundonte tek ura e Mesi; zona e Kirit që ishte në Bardhaj i Madh dhe i Vogël, midis lumenjve Kir dhe Drin; zona e Bërdicës midis lumenjve Drin dhe Bunë, si dhe zona e Taraboshit midis lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës.



Punime fortifikuese solide

Krahas këtyre masave në këto zona, në murin mbrojtës (ledhet), për të penguar përmbytjet nga vërshimi lumenjve, u ndërtuan në anën e djathtë të Kirit, punime të mëdha plotësuese me qëllim që ky mur të shfrytëzohej edhe për mbrojtje. Ndërsa brenda në qytet ishin bërë punime fortifikuese në lagjet Ajazëm e Tepe (afër kalasë) e që ndodhet në lartësinë e Tepes. Fortifikata të ndërtuara me shpejtësi vitin e fundit, tashmë, ashtu siç pritej, ishin gati të përballeshin me zjarrin e luftës. Gjithçka me fortifikimin ishte gati. Forcat mbrojtëse të Shkodrës, sidomos në Bardhaj e Bërdicë, ishin të detyruara që të plotësonin boshllëqet e krijuara, të pa mbuluara me punime, duke vazhduar punimet fortifikuese edhe nën zjarrin e armikut, veçanërisht të artilerisë. Në këtë mënyrë komanda e Garnizonit të Shkodrës mori masa që qytetin ta mbronte me një varg punimesh fortifikuese solide, duke filluar nga pjesa veriperëndimore e jugperëndimore, të mbështetur tek pengesat ujore si liqeni, lumenjtë Drini dhe Buna, mali i Taraboshit dhe lartësitë që rrethojnë Shkodrën, të cilat mbyllin pjesën më të madhe të kalimeve drejt qytetit.

Pikëmbështetjet në varësi të terrenit, kishin specifikat e tyre. Në fushë Shtoj ato ishin ndërtuar të përqëndruara në largësi të tilla (distance) për të mbyllur me forca të pakta hapësirat, ndërsa në Tarabosh, Bardhaj e Bërdicë ato ishin ndërtuar në pikat dominuese të terrenit. Pozicionet e para ishin ndërtuar në (atë) mënyrë

që të shfrytëzohej me efikasitet dhe maksimalisht zjarri i të gjitha armëve, pushkëve, mitralozëve dhe artilerisë. Gati të gjitha pikëmbështetjet ishin të përforcuara me pengesa teli të vendosur në atë formë që të siguronin mbrojtjen nga këmbësoria e armikut. Gjerësia e këtyre pengesave varej nga rëndësia e drejtimit. Në Bërdicë konfiguracioni dhe ekzistenca e terreneve moçalore kishte lejuar ndërtimin e gropave "thithëse" dhe llogoreve të mbushura me ujë. Duhet theksuar se, falë përparësive që jepte për mbrojtje terreni përreth Shkodrës, këto punime fortifikuese edhe pse në pjesën më të madhe ishin të karakterit fushor, kishin arritur në qëndrueshmërinë e objekteve gjysëm të përhershme.

Gjithashtu rajonet e mbrojtjes kishin një sistem të ngurtë ndërlidhjeje me telefon dhe me anë të dërgimit të sinjaleve me mjete të tjera, si dhe me korrierë. Në Tarabosh ishin instaluar disa aparate me pasqyra (talioGRAFë) që komuniknin dhe jepnin urdhra sinjale për rajonet e tjera të mbrojtjes. Strehimet për këmbësorinë në sistemin e brendshëm të transheve e hendeclidhjeve ishin ndërtuar vetëm në pikëmbështetje, ndërsa tek të tjerat ishin të groposura në tokë. Strehimet ishin të mbuluara me llamarinë të valëzuar, me pllaka hekuri dhe me thasë me rërë, për t'u mbrojtur nga zjarri i artilerisë së kalibrit të vogël.

U ndërtuan pikëmbështetje të lidhura me transhe

Drejtimi kryesor luftarak, sipas planit të fortifikimit të komandës së garnizonit të Shkodrës, kalonte nga bregu i majtë i Kirit në shpatet veriperëndimore të Bardhajt të Vogël, pastaj në shpatet verilindore dhe duke u kufizuar në bregun e majtë të Kirit. Nga kjo kuotë drejtimi kryesor luftarak kalonte nëpër ullishte deri në majë e më pas aty ku Bardhaj i Madh zbret në fushë.

Transhetë këtu ishin ndërtuar edhe në zonën e Shtojt sepse terreni ishte i njëjtë. Kjo ishte vija e transheve, të ndërprera, me qëndrimin në këmbë dhe me çerdhe zjarri të përforcuara me thasë me rërë dhe me dhe, ndërsa në vendet ku ishte e nevojshme me lesa të thurura. Direkt para transheve përfundonte ullishtja dhe krijohej një hapësirë rreth 400 m në të cilën nuk pengoheshin veprimet luftarake dhe sistemi i zjarrit. Pozicionet kryesore të artilerisë në Juglindje të Taraboshit të Madh ishin ndërtuar me objekte të tipit jo të përheshëm, ndërsa për pajisjet ishin ndërtuar llogore të tipit fushor, duke marrë parasysh shfrytëzimin e thasëve me rërë. Në zonën e Fushës u ndërtuan pikëmbështetje të lidhura njëra me tjetrën me transhe dhe të ndërthurura me pengesa teli me gjemba. U ndërtuan pozicione për bateritë e artilerisë. Në zonën e Malit të Taraboshit dhe kodrat e Tepes u ndërtuan pikëmbështetje togash të pajisuara me transhe, të përforcuara me mure dhe të pajisura me hendeclidhje. U ndërtuan pika vrojtimi e pikëmbështetje, tela me gjemba. Karakteristikë ishte se pikëmbështetjet mbulonin me zjarr njera tjetrën, si dhe krahët për t'u mbrojtur nga sulmet krahëmarrëse e shpinëmarrëse. Në zonën e Bërdicës u përgatitën 4 pikëmbështetje, 2 PZ bat-

erish, 2 pozicione për vendosjen e prozhektorëve. U ndërtuan dhe objekte prej guri ose guri dhe dheu. U ndërtuan rrugë karrocash e dekovili për transportimin e materialeve luftarake. U ndërtuan objekte për mbrojtjen e ruajtjen e ujit të pishëm si në Tarabosh dhe Fushën e Shtoit. Për fortifikimi e Shkodrës D. Tucoviç, shkruante: Llogoret e saj janë të maskuara, brenda në dhe e të ndërtuara prej betoni.

Së jashtmi nuk shihet gjë fare edhe me dylbitë më të mira. Kur fillojnë luftimet nuk dihet se nga të vjen zjarri. Janë ndërtuar një sërë pengesash të ndryshme si gropa që mbushen me ujë e të thurura me tel me gjemba që lidhen me shtylla të hekurta. E tërë fortifikata mbrohet me zjarrin e këmbësorisë, por edhe me atë të topave.

Liçeni i Shkodrës përbënte një pengesë tjetër. Nga Ura e Bunës mbrohej nga një anije e pajisur me topa e mitraloza. Kundërsulmet (daljet) nga pozicionet e fortifikuara siguronin një epërsi të madhe për forcat e garnizonit të Shkodrës.

Fortifikimi, faktor i rëndësishëm

Pajisja fortifikuese e pozicioneve të luftimit luajti rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e mbrojtjes. Shkodra nuk u pushtua dot me luftime, sepse faktori tepër i rëndësishëm ishte fortifikimi. Si përfundim, duhet theksuar se deri në fillim të veprimeve luftarake më 9 tetor 1912, ishin ndërtuar në përgjithësi rajonet e fortifikuara në Tarabosh, Shtojë e Bërdicë, por në asnjërën prej tyre nuk ishin përfunduar punimet e planifikuara. Zona e Kirit ishte më pak e fortifikuar, punimet në Bardhaj e Madh kishin filluar, kurse në Bardhaj e Vogël ende. Operacionet e para të ushtrisë malazeze rreth Shkodrës, i detyruan mbrojtësit e qytetit që të intensifikonin punimet fortifikuese, të cilat u përqëndruan kryesisht në zgjerimin dhe forcimin e pozicioneve të qitjes së këmbësorisë nga qëndrimi në këmbë, mjaft efikase në luftimet e zhvilluara sidomos në Shtojë e Tarabosh. Mangësitë e fortifikimit në Bardhaj të Madh e të Vogël paraqitën një rrezik të madh për qytetin edhe pse forcat kryesore të Grupimit malazes të Zetës sulmuan pikërisht në atë drejtim. Përgjatë shpateve veriore dhe jugore të Taraboshit u ndërtuan transhe të tjera, së bashku me hendeclidhjet. Meqënëse me afrimin e forcave malazeze në Muriqan rreziku më i madh vinte nga Oblika, aty u ndërtuan një brez i tërë transhesh duke u përforcuar më shumë nga ana e veriut. Krahas kësaj në anën perëndimore të Taraboshit dhe në disa kodra në jug dhe në jugperëndim të Shirokës, u ndërtuan transhe për të përforcuar mbrojtjen e kësaj ane. Në të gjithë gjatësinë e transheve në pjerrësitë e Taraboshit u vendosen pengesa me tela, me tre-katër radhë. I gjithë sistemi i fortifikimit ishte i lidhur me telefon.

Masat fortifikuese të marra me kohë, luajtën një rol të rëndësishëm dhe frenues të depërtimit të ushtrisë malazeze në Shkodër. Ky fortifikim, edhe pse i ndërtuar me shpejtësi dhe jo me të gjithë parametrat e duhur, luajti një rol vendimtar në qëndresën heroike të luftëtarëve dhe të popullatës së Shkodrës për mbrojtjen e qytetit të tyre.



FORCAT E ARMATOSURA KUNDËR COVID-19

Mjekët dhe infermierët angazhohen në vaksinimin masiv të popullsisë

